

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5904  
E martë, 15 tetor 2019  
çmimi 0.40 €

## Prokuroria heton zarfet me vota të ardhura nga Serbia

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### AKTUALE

## BE-ja kërkon mosemërimin e noterëve të rinj

FAQE 7



## POLICIA: 5 573 SHOFRERËVE U ËSHTË NDALUAR DREJTIMI I MJETIT

F.7



## GJILANI NDERON JETËN DHE VEPRËN E VEPRIMTARIT LIMON ISUFI

F.6

## MALISHEVA PËRKUJTON 15 MATURANTËT QË VDIQËN TRAGJIKISHT NË FUSHË-ARRËZ

F.11

### EKONOMI

## INSTITUCIONET SHPENZUAN 20 MILIONË EURO PËR REPREZENTACION, TELEFONA, KARBURANTE DHE PËR MËDITJE

F.9

## RAHOVECI INFORMON BIZNESET RRETH GRANTEVE TË BE-së

F.9

### KULTURË

## REXHEP QOSJA MERR ÇMIMIN SHKENCOR NDËRKOMBËTAR 'ALEKSANDËR STIPÇEVIQ - 2019'

F.6

FLET PËR "EPOKËN E RE", SAFET GËRXLHIU

FAQE 4-5

## TELEKOMI DHE TERMOCENTRALI 'KOSOVA E RE', SFIDUES PËR QEVERINË E ARDHSHME



Sekretari i përgjithshëm në Forumin Investiv të Odave të Ballkanit Perëndimor (WB6) me seli në Itali dhe ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Safet Gërxhaliu, ka thënë se ndër sfidat kryesore ekonomike me të cilat do të përballet

qeveria e ardhshme janë sundimi i rendit dhe i ligjit, çështja e privatizimit të Telekomit si dhe Termocentrali "Kosova e Re". Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se qeveria e re vëmendje të veçantë duhet t'i kushtojë avancimit

të raporteve me FMN-në dhe Bankën Botërore. Gërxhaliu ka folur edhe për zvogëlimin e ministrive. Ai ka theksuar se Kosovës nuk i duhen 22 ministri. "Një qeveri e mirëfilltë mund të funksionojë me 12 ministri", ka thënë Gërxhaliu

## KOSOVA VAZHDON SIGURT RRUGËTIMIN DREJTË 'EURO 2020'



Shkëlqimi i futbollistëve 'dardanë' në stadiumin 'Fadil Vokrri' dhe në kualifikimet për Kampionatin Evropian vazhdoi edhe të hënën në mbrëmje kur e mposhtën Malin e Zi (2-0). Kosova

vazhdon të jetë kandidate serioze për kualifikim në 'Euro 2020', por për të arritur një gjë të tillë i duhet të shkëlqen edhe në dy finalët e fundit ndaj Çekisë dhe Anglisë

## Shqipëria deklaso Moldavinë

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Komisioni i Venecias publikon opinionin final për presidentin Meta

**TRANË, 14 TETOR** - Komisioni i Venecias ka publikuar opinionin final për presidentin Ilir Meta, lidhur me veprimet e këtij të fundit sa i takon mos dekretimit të datës së zgjedhjeve të 30 qershorit.

Në dokument thuhet se rregullat kushtetuese për situata emergjente nuk ishin ndjekur. "Duket se fuqia e presidentit të Shqipërisë për të caktuar datat e zgjedhjeve duhet të jetë në përputhje me kërkesat e rrepta kushtetuese dhe fuqinë

për të caktuar datat e zgjedhjeve i jep presidentit vetëm një diskrecion të kufizuar, veçanërisht të zgjedh datat brenda kornizës së periudhave zgjedhore, duke mos i tejkaluar mandatet zgjedhore", thuhet në dokument.

"Një e drejtë e presidentit për të shtyrë ose madje anuluar zgjedhjet është e diskutueshme dhe nuk mund të themelohet pa një bazë të veçantë ligjore. Është e nevojshme të ekzaminohet nëse një fuqi e tillë mund të rrjedh në situata emergjente", thuhet aty.

Në përfundimet që Komisioni i Venecias nxjerr thuhet se, "në përgjigje të kërkesës për një mendim nga kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Komisioni i Venecias arrin në konkluzionin se, në mungesë të një dispozite ligjore për këtë çështje, presidenti mund të anulohet zgjedhjet vetëm për organet e qeverisjes vendore në një situatë që takohen kriteret për marrjen e masave emergjente. Edhe atëherë presidentit i duhen baza ligjore për të shtyrë zgjedhjet".



## Shqipëria temë kryesore në takimin e ministrave të BE-së

Diskutimi do të bazohet në konkluzionet e miratuara vitin e kaluar për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut dhe ku jepej mbështetje për hapjen e negociatave në vitin 2019-të, vendim i cili po kundërshtohet aktualisht nga Franca, Holanda dhe disa shtete të tjera



**BRUKSEL, 14 TETOR** - Sot (e martë) do të mbledhen në Luksemburg ministrat e jashtëm të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, të cilët do të përgatisin draftin me konkluzione për çështjet kryesore në agjendë. Drafti u kaloi me pas liderëve të shteteve, në samitin që do të mbahet më 17 dhe 18 tetor. Këshilli Evropian ka zbardhur edhe agjendën e takimit të ministrave të jashtëm, që zhvillohet sot (e martë). Procesi i zgjerimit të BE-së me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut do të jenë në krye të agjendës.

Diskutimi do të bazohet në konkluzionet e miratuara vitin e kaluar për dy shtetet ballkanike dhe ku jepej mbështetje për hapjen e negociatave në vitin 2019-të, vendim i cili po kundërshtohet aktualisht nga Franca, Holanda dhe disa shtete

të tjera.

Sa i përket Shqipërisë, në agjendën e takimit të sotëm thuhet: "Këshilli nënvizoi nevojën kritike që vendi të konsolidojë më tej përparimin e bërë në reformën gjyqësore në veçanti përmes vetting-ut, dhe të japë rezultate të mëtejshme të prekshme në luftën kundër korrupsionit në të gjitha nivelet dhe në luftën kundër krimit të organizuar, në veçanërisht në kultivimin dhe trafikimin e drogës. Kjo përfshinte, ndër të tjera, avancimin e mëtutjeshëm të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke përfunduar krijimin e strukturave të pavarura gjyqësore dhe organeve të specializuara si Struktura Speciale Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), dhe forcimin e hetimeve proaktive,

ndjekje penale dhe dënime përfundimtare në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, përfshirë nivelet e larta. Këshilli gjithashtu theksoi rëndësinë e rezultateve të mëtejshme të reformës, veçanërisht në sundimin e ligjit, reformën zgjedhore dhe zvogëlimin e numrit të kërkesave për azil", thuhet në draft konkluzionet e ministrave të jashtëm të BE-së. Ndërkaq, ministrat e jashtëm të katër vendeve anëtare të BE-së, kanë bërë thirrje për hapjen e bisedimeve për anëtarësim me Maqedoninë e Veriut dhe

Shqipërinë.

"Një vendim i Bashkimit Evropian për mundësinë e fillimit të negociatave me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë vjen në një kohë kur vendet anëtare po përballen me sfida të shumta", thuhet në letrën e bashkë-nënshkruar nga Tomas Petriček, ministri i Jashtëm çek, Peter Szijjarto, ministër i Jashtëm hungarez, Jacek Czaputoëicz nga Polonia dhe Miroslav Lajčak, kryediplomat i Sllovakisë.

"Sidoqoftë, çështjet që ndodhën përpara si Brexit-i, migracioni,

paqëndrueshmëria e vendeve fqinje, dhe mandati i Komisionit të ri Evropian, nuk duhet të na shpëpusin nga ajo që mund të arrijmë, nëse i përmbahemi angazhimeve në rajon", thuhet në letrën e tyre, të cilën e ka publikuar Politico.

Ministrat kujtojnë se perspektiva e anëtarësimit në BE u ishte premtuar të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor në samitin e vitit 2003 në Selanik, vetëm disa muaj pasi negociatat e pranimit me dhjetë anëtarë të rinj të BE-së u nënshkruan në Athinë.

## Kryeministri italian sot në Tiranë për negociatat me Shqipërinë



**TRANË, 14 TETOR** - Kryeministri italian Giuseppe Conte do të jetë sot (e martë) në Tiranë, dy ditë përpara vendimit të Bashkimit Evropian për hapjen apo jo të negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Kryeministri i vendit fqinj, Conte do të jetë në Shqipëri në një takim me kryeministrin Rama, për të dhënë mbështetje për vendin tonë. Takimi është në kuadër të çeljes së negoci-

atave dhe marrëdhënieve të mira mes dy vendeve tona. Ndërkohë, Italia e ka shprehur qëndrimin e saj prej kohësh për një votë pozitive për Shqipërinë, duke iu referuar reformave që janë ndërmarrë. Por mbi të gjitha për Italinë, tregues real i Shqipërisë që të meritojë negociatat është Reforma në Drejtësi, pavarësisht problemeve që ajo ka me Gjykatën Kushtetuese, apo

ritmet e ngadalta për ngritjen e SPAK dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit.

Nëse do të diskutohet që mbledhja e parë e kryeministrave të Bashkimit Evropian të zhvillohet të zhvillohet vitin e ardhshëm, burimet bëjnë me dije se Italia nuk do të kundërshtojë. Duket se ky mesazh do të jepet edhe nga kryeministri Conte gjatë takimit në Tiranë me homologun shqiptar.

Shtohet numri i kandidatëve për deputetë që kërkojnë rinumërim të votave

# Kandidatët për deputetë akuzojnë komisionarët për manipulim të votave



Disa kandidatë për deputetë, të cilët nuk kanë arritur të bëhen deputetë të Kuvendit të Kosovës, kanë drejtuar gishtin kah komisionarët e partive të veta duke i akuzuar ata se kanë manipuluar votat e qytetarëve. Sipas tyre, komisionarët e partive kanë bërë bartje të paligjshme të votave tek individët e tjerë favorizues. Kandidatët për deputetë kanë kërkuar rinumërim të votave, duke e ftuar Prokurorinë e Shtetit të merret me këtë çështje. Ndërsa njohësit e proceseve zgjedhore kanë bërë me dije se ky fenomen do të përsëritet derisa të kemi komisionarë partiakë

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 14 TETOR** - Ndonëse vlerësimet e përgjithshme për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit kanë qenë mjaft të mira, kështu nuk mendojnë disa kandidatë për deputetë që nuk kanë arritur të sigurojnë ulëse në Kuvendin e Kosovës. Ata një javë pas përfundimit të zgjedhjeve kanë filluar t'i akuzojnë komisionarët e partive të tyre se kanë manipuluar me vullnetin e qytetarëve, duke bartur votat e tyre tek individët e tjerë favorizues në mënyrë të paligjshme. Të fundit që kanë reaguar rreth këtij fenomeni janë ish-kandidati për deputet nga radhët e koalicionit AAK-PSD, Jahir Morina, dhe kryetari i Partisë Euroatlantike të Kosovës, Milaim Zeka.

I pari ka treguar edhe vendet ku

dyshon se i janë vjedhur votat. "Duhet të ketë rinumërim në Rahovec dhe në gjithë Kosovën. Dikush duhet të shkojë në gjykatë e të marrë dënim për keqpërdorim të vullnetit të qytetarëve të Rahovecit me rrethinë. Në postimin e kolegut tim, ku ai argumenton vjedhjen e votës, shihet qartë vjedhja e votës sime po në këtë qytet", ka shkruar Morina në profilin e vet në "Facebook". Sipas tij, qendrat e votimit janë keqpërdorur nga keqbërësit dhe mashtruesit që njollosen votën e lirë. "Të njolloset një proces kaq i rregullt zgjedhor nga qytetarët për mua dhe për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës është vepër penale dhe kërkon ndëshkim dhe dënim meritor me ligj. Në fletën llogaritëse janë disa vota, kurse në formularin zyrtar janë 0 vota", ka shkruar Morina.

Edhe Milaim Zeka ka akuzuar

komisionarët teksa në profilin e vet në "Facebook" ka postuar një formular në të cilin shihet se si më pas dikush i ka ndryshuar shifrat e vendosura fillimisht. "Shikoni çfarë komisionarësh kriminelë ka shteti i Kosovës?! Duhet për t'u gëzuar mos me qenë deputet në këtë vend", ka shkruar Zeka.

Një ditë më parë edhe kandidati për deputet i koalicionit AAK-PSD, Burim Ramadani, është ankuar në këtë drejtim duke përmendur qendrën e votimit në të cilën i janë vjedhur 58 vota. "Ja një rast qysh avullohen votat. Qendra e Votimit 2401A, Dhoma nr. 2. Në fletën llogaritëse janë 58 vota, në formularin zyrtar janë 0 vota. Pra, 58 qytetarë në Suharekë kanë votuar, por komisionarja Sh. K. ka vendosur që t'i avullojë ato vota. Sigurisht, duhet të ketë rinumërim. Sigurisht, dikush duhet të shkojë në gjykatë e të marrë dënimin", ka shkruar Ramadani në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërsa i pari që ishte ankuar në komisionarët e partisë është Blerim Latifi, kandidat i PDK-së për deputet. Ai në profilin e vet në "Facebook" ka shkruar se si ka ndodhur ky manipulim. "Gjatë fushatës më pyesnin njerëzit: Si i ke punët me komisionarët në vendvotime? Po me vëzhguesit? E si duhet t'i kem?, i pyesja. Për t'i ruajtur votat tua, më përgjigjeshin. Dhe vazhdonin: Nëse komisionarët nuk janë me

ty, votat t'i marrin dhe ua hedhin të tjerëve gjatë përpilimit të tabelave përfundimtare. Por, e keqja nuk sos këtu, sepse edhe në rastin kur komisionarët janë me ty, duhet t'i ruash ata, për arsye se vjen tjetri dhe t'i blen me para", ka shkruar ai, duke shtuar se demokracia e Kosovës është një manipulim. "Pra, thënë shkurt e shqip: demokracia kosovare, që në aktin e saj themelor është një mashtrim i madh, një pazar i ndytë komisionarësh e vëzhguesish. Vullneti i qytetarëve fillon e falsifikohet me t'u mbyllur qendrat e votimit. E pastaj ankohe mi se Evropa nuk po na i hapë dyert! Natyrisht që nuk na i hapë. Me horra nuk shkohet në Evropë. Me horra veç një rrugë është e hapur: rruga e shtetit të dështuar", ka shkruar Latifi. Blerjen e komisionarëve e ka përmendur edhe kandidati i AAK-së për deputet, Muharrem Nitaj. "Po thonë se shumë nga kandidatët me çanta me pare i paskan blerë mandatet e tyre. Më vjen keq për ta, se janë të mjerë. Po thonë që edhe shumë të tjerë paskan paguar shumë pare e nuk i paskan fituar mandatet. Për ta më vjen mirë së haram duhet t'i kanë pasur, por më së shumti ndiej keqardhje pse ata që nuk patën pare e duhej të ishin zgjedhur, nuk e kaluan pragun. Këtë herë nuk ishte koha e tyre", ka shkruar Nitaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Më tutje, ai ka shtuar se shumë nga kandidatët po kërkojnë të hapen kutitë që të rinumërohen votat një për një. "Mosni, se kjo nxjerrë telashe të mëdha, sepse shumë njerëz duhet të koriten, ndonjëri edhe të shkojë në burg, ndoshta, e kështu të prishet darka e qejfit të zgjedhjeve, he mos kofshin! Lëreni siç është, se më mirë as që duhej të ishte!", ka shkruar Nitaj.

Ish-anëtari i KQZ-së dhe njohësi i proceseve zgjedhore, Blerim Burjani, ka treguar për gazetën "Epoka e re" se ky fenomen ka ndodhur edhe më herët dhe do të ndodhë derisa të ketë komisionarë partiakë. "Gjithmonë ka pasur probleme të tilla dhe do të ketë edhe në të ardhmen derisa nuk ndodhë një reformë zgjedhore gjithëpërfshirëse, e cila do të përcaktojë që komisionarët nuk duhet të jenë partiakë, por shërbyes civilë", ka thënë Burjani, duke shtuar se ky problem është shfaqur prej kohës kur janë hapur listat. "Ka individë të partive politike që janë ankuar prej se janë hapur listat qoftë në garën për deputet apo në garën për këshilltar komunal. Pra, çdoherë ka pasur ankesa për manipulime të votave ose transferim joligjor të votave te personat e tjerë, ose bartje të paligjshme të votave tek individët e tjerë. Natyrisht se këto veprime janë në kundërshtim të plotë me Ligjin për Zgjedhje dhe me Kodin Penal", ka thënë Burjani.

Flet për "Epokën e re", Safet Gërxhliu

# Telekomi dhe Termocentrali 'Kosova e re'



Sekretari i përgjithshëm në Forumin Investiv të Odave të Ballkanit Perëndimor (WB6) me seli në Itali dhe ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Safet Gërxhliu, ka thënë se ndër sfidat kryesore ekonomike me të cilat do të përballet qeveria e ardhshme janë sundimi i rendit dhe i ligjit, çështja e privatizimit të Telekomit si dhe Termocentrali "Kosova e Re". Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se qeveria e re vëmendje të veçantë duhet t'i kushtojë avancimit të raporteve me FMN-në dhe Bankën Botërore. Gërxhliu ka folur edhe për zvogëlimin e ministrive. Ai ka theksuar se Kosovës nuk i duhen 22 ministri. "Një qeveri e mirëfilltë mund të funksionojë me 12 ministri", ka thënë Gërxhliu

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 14 TETOR - Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK) dhe njohësi i politikave ekonomike, Safet Gërxhliu, ka thënë se qeveria e ardhshme do të ballafaqohet me sfidën e sundimit të rendit dhe ligjit, termocentralin 'Kosova e Re', privatizimin e Telekomit të Kosovës, gjetjen e modelit të investimeve në 'Trepçë', negociatat me Serbisë, avancimin e marrëdhënieve fqinjësore. Sfida

të tjera, sipas tij, do të jenë institucionet ndërkombëtare si, "ta zëmë, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore".

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Gërxhliu ka thënë se duhet të përfillet modeli i investimit të partneritetit publiko-privat në çështjen e Telekomit dhe në çështjen e investimeve në "Trepçë". Ndërkaq sa i përket ndërtimit të Termocentralit "Kosova e Re", ai ka thënë se për këtë çështje ka mospajtime nga një grup

njerëzish brenda koalicionit fitues dhe opozitës që, sipas tij, duhet të rishikohet kontrata. "Sfida për qeverisjen e re do të jenë: sundimi i rendit dhe ligjit, zhvillimi ekonomik, pastaj çfarë do të ndodhë me Termocentralin 'Kosova e Re', projekt ky që ka rëndësi shumëdimensionale e që ka përkrahje të ndërkombëtarëve, veçanërisht Shteteve të Bashkuar të Amerikës dhe shteteve mikeve, pra vendeve evropiane. Në anën tjetër kemi edhe një grup të caktuar brenda

partisë fituese që e kundërshton këtë, po ashtu edhe shoqërinë civile. Prandaj, mendoj se ky termocentral do të jetë ndër sfidat kryesore. Pastaj e kemi dhe problemin me 'Trepçën'. Kur bisedohet për 'Trepçën' nuk mjafton vetëm të kemi ligj, por duhet të kemi një racionalizim që është në funksion të përmirësimit të ambientit për të bërë biznes. Besoj se partneriteti publiko-privat do të jetë një model ideal, por që duhet të analizohet edhe në rastin e 'Trepçës', ka thënë ai.

**"Epoka e re": Z. Gërxhliu, cilat janë pritjet tuaja sa iu përket çështjeve ekonomike për qeverinë e re?**

**Gërxhliu:** Në radhë të parë duhet të kuptohet që më 6 tetor fitoi Kosova dhe qytetarët e Kosovës. Më 6 tetor është demonstruar një frymë demokratike e zgjedhjeve që duhet të jetë model edhe për vendet e rajonit dhe më gjerë. Nuk duhet harruar në këtë rast rolin e diasporës pasi angazhi-

mi i saj ishte më i madhi për ndryshimet që ndodhën. Përdërisa fituesi tregoi një modesti dhe gjakftohtësi duke kontrolluar euforinë e fitores, humbësi, në këtë rast z. Veseli, tregoi një pjekuri dhe burrëri të një burrështetasi pasi e pranoi humbjen, duke thënë para medieve se PDK-ja do të jetë në opozitë. Besoj se përmes kësaj vote fitoi Kosova dhe ardhmëria e saj, duke e ndëshkuar arrogancën dhe distancën e pushtetit, pasi ajo që ka ndodhur në pesë vjetët e fundit më së paku ishte në interes të Kosovës dhe ardhmërisë së saj, më së shumti ka qenë e orientuar për përmbushjen e interesave dhe grupeve të caktuara. E tërë kjo e ka çuar Kosovën në këtë situatë ku tashmë jemi para sfidave të mëdha. Dua të besoj se është një moment që nuk duhet të përcillet me eufori dhe me patriotizëm folklorik. Për ata për të cilët vendosi sovranit, duhet ta kenë prioritet sundimin e rendit dhe ligjit, zhvillimin ekonomik dhe

# Re', sfidues për qeverinë e ardhshme

vave. Sfidat për qeverisjen e re do të jenë sundimi i rendit dhe ligjit, zhvillimi ekonomik, pastaj çfarë do të ndodhë me Termocentralin 'Kosova e Re', projekt ky që ka rëndësi shumë dimensionale dhe që ka përkrahje të ndërkombëtarëve, veçanërisht Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe shteteve mikeve, pra vendeve evropiane. Në anën tjetër, kemi edhe një grup të caktuar brenda partisë fituese që e kundërshton këtë, po ashtu edhe shoqërinë civile. Prandaj, mendoj se ky termocentral do të jetë ndër sfidat kryesore. Pastaj e kemi dhe problemin me 'Trepçën'. Kur bisedohet për 'Trepçën' nuk mjafton vetëm të kemi ligj, por duhet të kemi një racionalizim që është në funksion të përmirësimit të ambientit për të bërë biznes. Besoj se partneriteti publiko-privat do të jetë një model ideal, por që duhet të analizohet edhe në rastin e 'Trepçës'. Pastaj çfarë do të ndodhë me fatin e Telekomit të Kosovës që është në një situatë kritike. Në këtë drejtim, në aspektin interno, janë këto sfida me të cilat do të ballafaqohet Qeveria e Kosovës dhe nevojitet dialog intern. Kabineti i ri qeveritar duhet ta përmirësojë imazhin e Kosovës në mënyrë që të kemi investime të huaja të cilat kanë përjetuar rënie. Gjithashtu, duhet pasur parasysh normalizimin e raporteve me vendet fqinj duke zbatuar rekomandimet për ta rishikuar marrëveshjen e CEFTA-s. Mjaft sfidues do të jetë edhe normalizimi i raporteve me Serbinë, mirëpo vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet avancimit të raporteve me FMN-në dhe Bankën Botërore.

normalizimin e raporteve me vendet fqinje. Në qoftë se këto çështje nuk do të jenë prioritet, kam drojën se edhe qeverisja e ardhshme do të jetë e dështuar.

**"Epoka e re":** Ku duhet të jetë përqendrimi ekonomik?

**Gërzhaliu:** Duhet të kuptohet se problemet nga e kaluara janë të grumbulluara dhe duhet të kuptohet se asnjë qeveri nuk e ka shkopin magjik për t'i zgjidhur ato probleme për një kohë të shkurtër. Çdo qeveri duhet t'i humbë disa vjet jo për t'i përmirësuar, por për t'i ndalë gabimet e trashëguara nga qeveria e kaluar, e cila burgosi popullin me izolim, qoftë me demarkacion, qoftë me populizëm përmes mënyrave të ndryshme. Prandaj, nuk është e rrugës të bëhet presion që për një kohë të shkurtër të zgjidhen këto probleme. Dua të besoj se vetë fakti që shpresojmë se do të ketë një koalicion të madh mes dy partive fituese, do ta mundësojë realizimin e objekti-

qeveri e mirëfilltë mund të funksionojë me 12 ministri, atë të Financave, që është shtyllë e menaxhimit të parasë publike dhe ajo e Zhvillimit Ekonomik, në të cilën mund t'i inkorporojë ministrinë e tjera. Prandaj, besoj se duhet të bëhet më tepër në reformim të administratës publike dhe reformim të stafit në mënyrë që të jenë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe jo barrë e buxhetit.

**"Epoka e re":** Z. Gërzhaliu, cili është mendimi juaj rreth privatizimit të Telekomit të Kosovës?

**Gërzhaliu:** Bazuar në indikatorët aktualë, Telekomit i Kosovës nuk

ka kuptim që të vazhdojë në këtë mënyrë, por duhet të shikohen format më të avancuara të privatizimit. Një qeveri me një vizion të qartë mund të gjejë forma të avancuara të privatizimit dhe partneritetit publiko-privat, ku pjesa dërrmuese e aksioneve i takojnë qeverisë dhe pjesa tjetër investitorëve të huaj. Në këtë drejtim, pos aspektit ekonomik, duhet të jemi vigjilentë që t'i tërheqim brendët e teknologjisë nga mbarë bota. Sot e kemi 'Deutsche Telekom' dhe 'Vodafone', kompani nga Norvegjia dhe të tjera që janë mjaft të suksesshme dhe duhet vërtet që përmes privatizimit të

Telekomit të kemi rezultate pozitive.

**"Epoka e re":** A duhet të ndërtohet "TC Kosova e Re" dhe çfarë pasojash mund të ketë dështimi i këtij projekti?

**Gërzhaliu:** Nëse e analizoni praktikën aktuale në vendet e rajonit dhe vendet që kanë shumë më pak thëngjill, shikoni Maqedoninë, Malin e Zi, Bosnjë dhe Hercegovinën dhe Serbinë, besoj se kontrata duhet të analizohet më mirë. Kosova ka nevojë për kapacitete të tjera gjeneruese pasi në qoftë se flemë mbi thëngjill dhe ballafaqohesh me të, atëherë je duke e përjetuar 'mallkimin e hirtë' që quhet në shkencë.

## Prokuroria heton zarfet me vota të ardhura nga Serbia

PRISHTINË, 14 TETOR (ER) - Prokuroria e Shtetit dhe Policia e Kosovës janë duke kryer ekzaminimet e nevojshme për t'i zbuluar hollësitë se si ka ndodhur helmimi i punonjësve në Qendrën e Numrit dhe Rezultateve nga votat në zarfet të ardhura nga Serbia. Zëdhënësi i Prokurorisë së Shtetit, Ekrem Lutfiu, për vazhdimin e punës së mëtejme, ka thënë se janë duke pritur edhe rezultatet e analizave toksikologjike. "Sapo e kemi pranuar informatën, prokurori i shtetit ka dalë në vendin e ngjarjes për t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme, hetimet. Për pjesën tjetër për momentin nuk mund të japim informata të tjera. Sapo t'i marrim rezultatet e analizave [shëndetësore], atëherë besoj se Prokuroria do të jetë në

gjendje që të deklarohet lidhur me këtë çështje", ka deklaruar Lutfiu për "Radion Evropa e Lirë". Kurse Policia e Kosovës nuk ka dhënë ndonjë informatë shtesë lidhur me hetimet që po zhvillon, derisa në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kanë thënë se janë duke pritur autoritetet kompetente që të dalin me përfundimet e tyre lidhur me këtë rast, në mënyrë që më pas KQZ-ja ta vazhdojë punën normale. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është takuar të hënën me kryetaren e KQZ-së, Valdete Dakën, kryeprokuroren e Shtetit, Aleksandër Lumezin dhe drejtorin e AKI-së, Shpend Maxhunin, të cilët e kanë informuar për rezultatet e hetimeve rreth raporteve për helmim të punëtorëve të KQZ-së, të cilët

kishin kontakt me zarfet e ardhur prej jashtë Kosovës në objektin e shërbimit të votuesve, ku ishin të vendosura votat e diasporës. "Kërkoj nga institucionet shtetërore që me profesionalizëm të hetohet tërë rasti dhe të ndërmerren të gjithë hapat e nevojshëm për t'i zbardhur dyshimet për helmim të personelit të KQZ-së", ka thënë presidenti Thaçi. Përfaqësuesit e institucioneve shtetërore njoftuan se pritet të përfundohet ekzaminimi i mostrave të zarfeve të marra në Shërbimin e Votuesve. Ekzaminimet, sipas tyre, do të bëhen së bashku me ekspertë ndërkombëtarë, ndonëse nuk është saktësuar se cili laborator ndërkombëtar do të mund t'i kryejë ato.



**"Epoka e re":** Pra, edhe me FMN-në dhe Bankën Botërore qeveria e re duhet të ketë kujdes?

**Gërzhaliu:** Kosova nuk e ka komoditetin t'i prishë marrëdhëniet me FMN-në siç ka ndodhur në dy vjetët e fundit, pasi rëndësia e këtij institucioni sa është ekonomike, aq është edhe strategjike. Prandaj, besoj se këto raporte do të jenë prioritare. Gjithashtu, dua të besoj se qeveria e ardhshme do të orientohet në ekspertizë shkencore dhe dijeni, duke depolitizuar administratën publike. Me një fjalë, më e lehta që mund të bëjë qeveria e re është që mos t'i bëjë gabimet e qeverisë paraprake.

**"Epoka e re":** Sa ministri ekonomike janë të nevojshme?

**Gërzhaliu:** Kosovës nuk i duhen 20 ministri, as 22 ministri. Një

# Rexhep Qosja merr çmimin shkencor ndërkombëtar 'Aleksandër Stipçeviq - 2019'

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 14 TETOR - Kolegji "Iliria" ka organizuar ndarjen e çmimit shkencor ndërkombëtar "Aleksandër Stipçeviq - 2019". Ky çmim këtë vit i është dhënë akademik Rexhep Qosjes për kontributin e jashtëzakonshëm shkencor shumëvjeçar në shkencat albanologjike, në shkencën e letërsisë, në krijimtarinë letrare, në kulturë, në publicistikë dhe në veprimtarinë universitare. Me këtë rast, akademik Rexhep Qosja ka vlerësuar lart jetën dhe veprën e Aleksandër Stipçeviqit. Ai ka thënë se është i nderuar që ka marrë çmimin me emër të tij. Qosja para të pranishmëve ka shprehur pikëpamjet lidhur me zhvillimet aktuale, ecuritë

shoqërore e politike si dhe për perspektivën e Kosovës dhe popullit shqiptar.

Në ceremoninë e dhënies së çmimit shkencor ndërkombëtar "Aleksandër Stipçeviq - 2019" kanë marrë pjesë personalitete të shquara akademike, universitare, dashamirës të shkencës dhe arsimit, profesorë, studentë dhe punonjës shkencorë të Kolegjit "Iliria".

Fjalë përshëndetëse, përveç presidentit të Kolegjit "Iliria", profesor Mixhait Reçit, kanë mbajtur edhe rektori i Kolegjit, Isak Shema, sekretari i parë i Ambasadës së Kroacisë në Kosovë, Zlatko Vnuçec.

Çmimi shkencor ndërkombëtar "Aleksandër Stipçeviq" në vitin 2018 i është dhënë akademik Muzafer Korkutit, kurse në vitin 2017 akademik Idriz Ajetit.



## Gjilani nderon jetën dhe veprën e veprimtarit Limon Isufi

GJILAN, 14 TETOR (ER) - Me rastin e ndarjes nga jeta të veprimtarit dhe atdhetarit Limon Isufi, nën përkujdesjen e kryetarit të Komunitetit të Gjilanit, Lutfi Haziri, është organizuar të hënën mbledhje përkujtimore në nderim të jetës dhe veprës së tij. Kryetari i Komunitetit, Lutfi Haziri, përmes një telegrami ngushëllimi ka thënë se baca Limon gjatë gjithë jetës ka qenë në krah të organizimeve dhe iniciativave për kauzën kombëtare. "Baca Limon, me qëndrimin e vendosur për kauzën kombëtare, gjatë gjithë jetës ka qenë në krah të organizimeve dhe iniciativave. Ai me frymën e atdashedashurisë rriti dhe edukoi familjen, duke mos u kursyer asnjëherë për të mirën e ven-

dit. Ai ishte strehë e sigurt për të gjithë veprimtarët e ilegales. Lavdi e përjetshme jetës dhe veprës së tij!", ka thënë Haziri.

Ndërkaq kryesuesja Shpresa Kurteshi Emini ka thënë se Limon Isufi me personalitetin e tij sot u mungon qytetarëve të Gjilanit, më së shumti familjes dhe miqve të tij.

Në emër të kryeministrit në largim, Ramush Haradinaj, ka folur zëvendësministri në detyrë i Infrastrukturës, Rexhep Kadriu, i cili ka pohuar se "këshillat që na i dha baci Limon, durimi që kishte për gjatë tërë jetës së tij, le të shërbejë si udhërrëfyes për ne që ta ndërtojmë të ardhmen".

Në emër të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së ka folur Qëndrim Baftiu, i cili ka thek-

suar se Limon Isufi ishte një aktivist e humanist, atdhetar i devotshëm dhe pjesëmarrës në shumë ngjarje me rëndësi që nga Lufta e Dytë Botërore. Ndërsa në emër të familjes Isufi ka folur vajza e Limonit, Sania, e cila ka thënë se me organizimin e kësaj mbledhje përkujtimore komuna nuk e ka nderuar vetëm familjen e saj, por edhe vetën dhe qytetarët e Gjilanit.

Telegrame ngushëllimi për familjen Isufi ka dërguar edhe kryeministri në largim, Ramush Haradinaj, rektori i Universitetit Publik "Kadri Zeka", Bajram Kosumi dhe familja e kolosit të kombit, Rexhep Malaj.

Varrimi i të ndjerit është bërë të hënën në varrezat e qytetit të Gjilanit.



## Universiteti i Shkencave të Aplikuara hap konkurs plotësues për studime master

FERIZAJ, 14 TETOR (ER) - Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF) ka hapur të hënën konkursin plotësues për pranimin e studentëve të rinj në nivelin master për vitin akademik 2019/2020. Në këtë afat të konkursit, në nivelin master do

të pranohen 92 studentë të rregullt, prej të cilëve 18 vende janë rezervuar për komunitetet joshumicë, tre për kandidatët nga Mali i Zi, tre për kandidatët nga Presheva, Bujanovci dhe Medvegja dhe tre për kandidatët nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut.

Kandidatët për studentë të UShAF-it në nivelin master në këtë afat të konkursit do të kenë mundësi të aplikojnë në programet: Arkitekturë dhe Dizajn i Interierit me Prodhime nga Druri; Inxhinieria dhe Informatika; dhe Menaxhimi dhe Inovacioni në Turizëm.



# BE-ja kërkon mosemërimin e noterëve të rinj

Zyra e Bashkimit Evropian (BE) në Prishtinë ka kërkuar nga institucionet në largim që të mos marrin vendim për emërimin e noterëve të rinj pasi, sipas BE-së, kjo detyrë duhet t'i lihet Qeverisë së re të Kosovës. Ndaj kësaj kërkesë ka reaguar ministri në detyrë i Drejtësisë, Abelard Tahiri, duke thënë se emërimi i noterëve të rinj është tërësisht legjitim. Ai ka thënë se ky proces do të marrë epilog legjitim në harmoni të plotë me ligjin dhe në partneritet të plotë me Odën e Noterëve të Republikës së Kosovës. Sipas Tahirit, pezullimi i këtij procesi do të ishte mesazh i rëndë për sundimin e ligjit

EPOKA  
ERE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 14 TETOR - Zyra e Bashkimit Evropian (BE) në Prishtinë të hënën ka kërkuar nga institucionet në largim të Kosovës që të mos marrin vendim për emërimin e noterëve të rinj pasi, sipas BE-së, kjo duhet t'i lihet Qeverisë së re të Kosovës. "U bëjmë thirrje autoriteteve në largim të Kosovës që të përmbahen nga çdo emërim i ri i noterëve sepse ne besojmë fuqishëm se ky vendim duhet t'i lihet qeverisë së re", është thënë në reagimin e Zyrës së BE-së në Prishtinë.

Zyra e BE-së në Prishtinë ka kërkuar që procesi i përzgjedhjes së noterëve të rinj të bëhet në përputhje me ligjet në fuqi, me qëllim që të shmangen parregullsitë. "Procesi i përzgjedhjes së noterëve është thelbësor për ta nxitur besimin e shoqërisë ndaj personave që kanë këtë rol me përgjegjësi", është theksuar më tutje në reagim.

Ndaj kësaj kërkesë ka reaguar ministri në detyrë i Drejtësisë, Abelard Tahiri, duke thënë se emërimi i noterëve të rinj është tërësisht legjitim. Nëpërmjet një deklarate për medie Tahiri ka thënë se emërimi i noterëve të rinj do të marrë epilog legjitim në harmoni të plotë me ligjin dhe në partneritet të plotë me Odën e Noterëve të Republikës së Kosovës. Sipas Tahirit, pezullimi i këtij procesi do të ishte

mesazh i rëndë për sundimin e ligjit. "Përballë ftesës së Zyrës së BE-së për pezullimin e emërimit të noterëve të rinj, si ministër i Drejtësisë vlerësoj se emërimi i noterëve të rinj, mbi formulën që është paraparë si e domosdoshme dhe emergjente për t'i përmbushur nevojat e qytetarëve, veçmas komuniteteve joshumicë, është tërësisht legjitim dhe duhet të ndodhë. Për më tepër, secili nga kandidatët që është testuar dhe ka kaluar fazat e provimit ka fituar një të drejtë ligjore të cilën unë nuk mund ta hedh poshtë në mënyrë arbitrare. Një veprim i tillë do të ishte mesazhi më i rëndë për sundimin e ligjit. Kemi punuar shumë që të vendosim standarde të mirëfillta të barazisë para ligjit dhe moscenimit të së drejtës së individëve të lirë të kësaj shoqërie që përfitojnë statusin e tyre në mënyrë legjitime dhe mbi bazën e ligjit. Ky postulat i domosdoshëm nuk është subjekt i ujdive politike të askujt dhe të asgjëje. Nuk ka asnjë garanci, as nevojë dhe as arsye që një proces i tillë i nisur dhe realizuar në mënyrë legjitime të lihet anash e të mos marrë epilog, së paku për ato raste që janë emergjente. Për njohuri të opinionit publik, dëshiroj të sqaroj se ky proces do të marrë epilog legjitim në harmoni të plotë me ligjin dhe në partneritet të plotë me Odën e Noterëve të Republikës së Kosovës", është thënë në

deklaratën e ministrit Tahiri. Më tutje, ai ka rikujtuar se reforma e sistemit noterial ka nisur që në fillim të vitit 2018 dhe bashkë me BE-në dhe në përputhje me standardet e BE-së është hartuar dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin e ri për Noterinë. Sipas Tahirit, procesi i përzgjedhjes së noterëve ka filluar shumë kohë më parë para se të dorëhiqej qeveria Haradinaj. "Në kuadër të zbatimit të ligjit të ri dhe formulës së re 1 noter në 10 mijë banorë në prill të këtij viti shumë kohë para se të dorëhiqej qeveria e kryeministrit Haradinaj kemi analizuar nevojat e qytetarëve dhe kemi shpallur konkursin publik për rekrutimin e noterëve të rinj. Rënia e qeverisë e ka gjetur procesin pothuajse të përfunduar. Pra, nuk ka qenë një reformë që e kam nisur aty për aty, por një reformë e domosdoshme që është nisur dhe është zhvilluar përgjatë dy vjetëve të fundit. Në fazën e rekrutimit, secili hap në këtë proces është bërë në përputhje të plotë me ligjin dhe aktet përcjellëse. Testimi i kandidatëve është bërë në Akademinë e Sigurisë Publike nën

vëzhgimin e kamerave, ndërsa testi është përpiluar nga anëtarët e Komisionit Profesional, vetëm një orë para mbajtjes së provimit", është thënë në deklaratën për medie të ministrit Tahiri. Më tutje, është theksuar se në përputhje me rrethanat, anëtarët e Komisionit për Dhënien e Provimit të Noterisë kanë shmangur konfliktin e interesit, që është konfirmuar tashmë nga institucioni kompetent për këtë çështje, Agjencia Kundër Korrupsionit, me opinionin që ka dorëzuar tashmë pranë Ministrisë së Drejtësisë. "Në anën tjetër, lidhur me pretendimet për parregullsitë eventuale ne kemi pritur palë të interesuara, përfshirë ambasadorë nga vendet e Bashkimit Evropian, të cilëve ua kemi sqaruar në detaje rrethanat dhe ecurinë e këtij procesi", është thënë në deklaratë. Po në këtë deklaratë për medie është theksuar se përgjatë dy vjetëve të fundit, pikërisht me ndihmën e Bashkimit Evropian dhe partnerëve zhvillimorë - Shteteve të Bashkuara të Amerikës - janë realizuar dhe përmbyllur shumë projekte kap-

itale në fushën e sundimit të ligjit. "Në mesin e reformave të ndërmarra ka qenë edhe qasja në drejtësi për qytetarët e Republikës së Kosovës, të përkthyer në ofrimin e shërbimeve sa më afër tyre përmes profesioneve të lira ligjore. Që nga themelimi i këtyre profesioneve askush nuk është marrë me to, as për nga matja e performancës, as për nga nevojat për rritjen e efikasitetit të shërbimeve ndaj qytetarëve. Kam pasur kërkesa nga komunitetet për t'iu mundësuar qasje në shërbimet noteriale sa më afër vendbanimeve të tyre dhe kam pasur edhe pyetje parlamentare nga deputetët pse një gjë e tillë ende nuk po ndodhte. Përballë realitetit, reformimi i profesioneve të lira ka qenë ndër detyrat e mia të para si ministër i Drejtësisë", është theksuar në deklaratën e ministrit Tahiri. Procesi i përzgjedhjes së noterëve më herët është kritikuar nga organizatat e shoqërisë civile për shkak se ky proces është bërë në kohën kur Qeveria e Kosovës është në largim dhe kanë kërkuar nga ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, të mos emërojë asnjë noter të ri.



## Policia: 5 573 shoferëve u është ndaluar drejtimi i mjetit

PRISHTINË, 14 TETOR (ER) - Policia e Kosovës vazhdon aktivitetet që kanë për qëllim ngritjen e vazhdueshme të sigurisë në trafikun rrugor si dhe uljen e aksidenteve. Sipas një njoftimi

për media të policisë, gjatë periudhës kohore janar-shtator 2019 5 573 shoferëve u është ndaluar drejtimi i mjetit me veprim motorik, ndërkaq 12 285 shoferëve u kanë vendosur pikë

negative. "Apelojmë që të respektohen rregullat në trafikun rrugor, në të kundërtën mund të mbeteni pa patentë shofer", është theksuar në njoftimin e Policisë së Kosovës.

# Institucionet shpenzuan 20 milionë euro për reprezentacion, telefona, karburante dhe për mëditje

Instituti GAP ka njoftuar se, sipas raportit vjetor financiar 2018 të Ministrisë së Financave, gjatë vitit 2018 të gjitha institucionet publike kanë shpenzuar në total rreth 20 milionë euro për reprezentacion, përdorim të telefonave mobilë, karburante për vetura si dhe mëditje për udhëtimet brenda dhe jashtë vendit. Sipas Institutit GAP, duke u bazuar në postet drejtuese, në institucionet për të cilat kanë të dhëna, këshilltarët politikë kanë shpenzuar më së shumti për mëditje dhe përdorim të telefonave mobilë, kurse zëvendësministrat kanë shpenzuar më së shumti për reprezentacion dhe për karburante për vetura

udhëtimet brenda dhe jashtë vendit. Secila nga këto kategori ka pasur rritje nga viti 2017, ku shpenzimet për mëditje janë rritur për 45 për qind, për reprezentacion për 18 për qind, për telefona mobilë për 30 për qind si dhe për karburante 1 për qind", është thënë në këtë komunikatë të GAP-it.

Për disa vjet me radhë Instituti GAP ka publikuar të dhëna për shpenzimet e ministrave e ministereve dhe zyrtarëve të kabineteve të tyre për mëditje, telefoni mobile, karburante dhe reprezentacion. Instituti GAP ka njoftuar se të dhënat për këto shpenzime janë mbledhur përmes kërkesave zyrtare në institucionet përkatëse ngaqë ato nuk publikohen në faqet zyrtare të institucioneve. "Në të shumtën e rasteve një numër i konsiderueshëm i ministrave

vazhdojnë të mos përgjigjen në kërkesat tona si, për shembull, Zyra e Kryeministrit në tre vjetët e fundit është përgjigjur vetëm për shpenzimet e vitit 2017; Ministria e Punëve të Jashtme nuk na është përgjigjur për tri vjet me radhë, Ministria e Administratës Publike për dy vjet me radhë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është përgjigjur pjesërisht apo nuk është përgjigjur fare", është thënë, ndër të tjera, në komunikatën e GAP-it. Sipas Institutit GAP, duke u bazuar në postet drejtuese, në institucionet për të cilat kanë të dhëna, këshilltarët politikë kanë shpenzuar më së shumti për mëditje dhe përdorim të telefonave mobilë, kurse zëvendësministrat/et kanë shpenzuar më së shumti për reprezentacion dhe për karburante për vetura.

**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 14 TETOR** - Instituti GAP ka publikuar shpenzimet e Qeverisë së Kosovës për mëditje të udhëtimeve zyrtare, telefona mobilë, reprezentacion dhe karburante për vetura për vitin 2018. "Mëditjet për udhëtimet zyrtare brenda dhe jashtë shtetit përbëjnë një shumë të majme të shpenzimit të parasë

publike", është thënë në komunikatën e GAP-it. Po sipas GAP-it, miliona euro të buxhetit të Kosovës shpenzohen për mbushjen e veturave zyrtare me karburante, për mbushjen e telefonave mobilë, po ashtu edhe për shpenzime të reprezentacionit (ku hyjnë shpenzimet e drekave dhe të darkave zyrtare). "Si shpenzime direkte të ndërlidhura me postet e politikanëve apo zyr-

tarëve publikë është e rëndësishme të analizohet se sa shpenzohet buxheti për këto kategori dhe kush janë shpenzuesit më të mëdhenj. Sipas raportit vjetor financiar 2018 të Ministrisë së Financave, gjatë vitit 2018 të gjitha institucionet publike kanë shpenzuar në total rreth 20 milionë euro për reprezentacion, përdorim të telefonave mobilë, karburante për vetura si dhe mëditje për





## Shpallen fituesit e Nobelit për Ekonomi

STOCKHOLM, 14 TETOR - Akademia Mbretërore Suedeze e Shkencave ua ka ndarë çmimin Nobel për Ekonomi ekonomistëve Abhijit Banerjee, Esther Duflo dhe Michael Kremer për punën e tyre në zbutjen e varfërisë botërore.

Banerjee dhe Kremer janë shtetas të ShBA-së, ndërsa Duflo ka nënshtetësi të dyfishtë amerikane dhe franceze. "Hulumtimi i kryer nga këta ekonomistë ka përmirësuar ndjeshëm aftësinë tonë

për ta luftuar varfërinë botërore. Në vetëm dy dekada qasja e tyre e re e bazuar në eksperimente ka transformuar ekonominë e zhvillimit", ka njoftuar Akademia Mbretërore Suedeze e Shkencave.

Treshja fituese e çmimit do ta ndajë shpërblimin prej rreth 908 mijë dollarësh amerikanë. Javën e kaluar në Stokholm u ndanë edhe çmimet Nobel për letërsi, mjekësi, fizikë, kimi dhe paqe.



## Diskutohet për organizimin e trajnimeve të gjykatëseve me ekspertë nga Kroacia

Prishtinë, 14 tetor (ER) - Drejtori i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës (ShSK), Sami Mazreku, është takuar të hënën në Prishtinë me ushtruesen e detyrës së drejtorit të Institutit të Drejtësisë, Luljeta Hetemi, me të cilën ka biseduar për organizimin e trajn-

imeve të gjykatëseve me ekspertë nga Kroacia. "Gjatë takimit Mazreku e Hetemi diskutuan për organizimin e trajnimeve për gjykatëse me ekspertë nga Kroacia për fushën e sigurimeve", është bërë me dije në njoftimin e ShSK-së.



## Rahoveci informon bizneset rreth granteve të BE-së

RAHOVEC, 14 TETOR (ER) - Komuna e Rahovecit ka mbajtur sesion informues për bizneset dhe OJQ-të lidhur me thirrjen për aplikim në kuadër të asistencës me grante, e financuar të Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Projekti synon përmirësimin e

qasjes së grupeve të pafavorizuara, konkretisht për gratë dhe të rinjtë në tregun e punës përmes ndërmarrjes sociale dhe masave aktive të tregut të punës.

Artan Asllani, drejtor për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm në Komunën e

Rahovecit, ka thënë se thirrja që është publikuar nga Zyra e BE-së në Kosovë ka për qëllim përmirësimin dhe qasjen e sektorit privat, konkretisht të ndërmarrjes së komunave të Kosovës dhe që në mënyrë direkte ndihmon përmirësimin dhe jetën e zhvillimit të

aktiviteteve në të bërit biznes. "Uroj që nga kjo thirrje të jenë përfitues bizneset apo shoqëria civile në Komunën e Rahovecit", ka thënë ai. Qazim Pirana nga AZhR-Jug u shpreh se sot janë këtu për ta paraqitur në detaje thirrjen e cila është publikuar nga Zyra e

BE-së në Kosovë, duke uruar që nga Komuna e Rahovecit të ketë përfitues nga kjo thirrje. Ky sesion informues është mbajtur në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal të Rahovecit, në organizim të Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.



## Zhvillonin baste të kundërligjshme sportive, arrestohen dy persona në Deçan

DEÇAN, 14 TETOR (ER) - Policia e Kosovës ka arrestuar dy persona në Deçan të cilët dyshohet se kanë zhvilluar veprimtarinë e kundërligjshme të basteve

sportive. "Përveç të dyshuarit në atë lokal janë hasur edhe pesë persona, klientë. Njësi i përkatës i policisë ka konfiskuar: një laptop, dy printerë, katër resiverë, dy DVR, dy vire-

lesa, shtatë monitorë dhe një numër të konsiderueshëm i tiketave të shtypura për lojërë të ndryshme", thuhet në raportin 24 orësh të policisë. Në vendin e ngjarjes kanë dalë

edhe inspektorët komunalë të cilët e kanë mbyllur lokalin, kurse të dyshuarit, pas intervistimit, me vendim të prokurorit, janë dërguar në mbajtje.



## 'EC Ma Ndryshe': Komuna e Prizrenit nuk respekton dispozitat e Ligjit për qasje në dokumente publike

PRIZREN, 14 TETOR (ER) - Qeveria komunale e Prizrenit nuk është duke i respektuar dispozitat ligjore për qasje në dokumente publike në rastin e kërkesës së OJQ-së 'EC Ma Ndryshe', lidhur me emërimin, përkatësisht zëvendësimin e një anëtari të Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e projekteve të OJQ-ve për mbështetje financiare publike sipas thirrjes publike nga fushat e turizmit dhe zhvillimit ekonomik në Komunën e Prizrenit për vitin 2019. "EC Ma Ndryshe" nga fundi i muajit korrik ka kërkuar nga Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik vendimin për zëvendësimin e një anëtari të këtij Komisioni, me saktësisht të drejtorit ekzekutiv të EC-it. Drejtoresha e Turizmit fillimisht ka pohuar se përgjigjet ndaj kësaj kërkesë do t'i ofrojë pas kthimit nga pushi-

mi, ndërkohë që më pas ka sugjeruar që kërkesa të adresohet në Drejtorin 'EC Ma Ndryshe' më 3 shtator 2019 ka adresuar kërkesën për qasje në dokumente publike në DTZHE. Pas kësaj kërkesë, drejtoresha e DTZHE-së, Sevil Kazaz, përmes një përgjigjeje të ofruar më 6 shtator 2019 ka kërkuar nga EC-i që t'u drejtohet organeve kompetente të cilët kanë lëshuar vendimin, pa dhënë asnjë sqarim shtesë orientues, siç obligon legjislacioni në fuqi për qasje në dokumente publike", është thënë në komunikatën e 'EC Ma Ndryshe'.

Po më 12 shtator kërkesa e njëjtë nga ana e EC-it i është adresuar Zyrës së kryetarit të komunës së Prizrenit, ku edhe kjo e fundit nuk ka ofruar përgjigje, përkatësisht nuk ka lejuar qasjen në dokumentin publik. "EC Ma Ndryshe"



përkujton se parimet e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike përkufizojnë se e drejta për qasje në dokumente

publike e secilit person, si dhe garantimi dhe përmbushja e kësaj të drejte nga ana e institucioneve publike, përbën

një prej themeleve të institucioneve demokratike dhe transparente", është thënë në këtë komunikatë për media.

## Komuna e Drenasit të enjten prezanton planin lokal të veprimit në mjedis

DRENAS, 14 TETOR (ER) - Komuna e Drenasit, respektivisht Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, fton të interesuarit që më 17 tetor (e enjte), duke filluar nga ora 14:00, të marrin pjesë në debatin publik që do të mbahet në Sallën e Kuvendit Komunal. Në këtë debat publik do të prezantohet Plani Lokal i Veprimit në Mjedis (PLMV) i cili është dokument planifikues-strategjik, për ta

adresuar zgjedhjen e problemeve mjedisore në nivel lokal që, duke u bazuar në këto probleme mjedisore, janë përcaktuar prioritetet mjedisore për periudhën pesëvjeçare.

Qëllimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis është që të identifikojë dhe të ofrojë zgjidhje për problemet prioritare mjedisore në Komunën e Drenasit, duke synuar menaxhim efektiv. "Prandaj, duke pasur parasysh

ndikimin e rëndësishëm që mund të ketë PLMV-ja, inkurajohen të gjithë të interesuarit, duke përfshirë shoqërinë civile, profesionistët dhe ekspertët e fushave relevante, të marrin pjesë në debat publik dhe të kontribuojnë në dhënien e vërejtjeve, sugjerimeve eventuale që do të ndikojnë në zgjidhjen e problemeve mjedisore në nivel lokal", është thënë në njoftimin e Komunës së Drenasit.



## Përfundojnë punimet e vrazhda në shtëpinë bjeshkatore në Junik

JUNIK, 14 TETOR (ER) - Komuna e Junikut ka njoftuar se kanë përfunduar punimet e vrazhda në shtëpinë bjeshkatore në lokacionin Gropa e Erenikut, projekt ky që ka për qëllim ofrimin e shërbimeve të avancuara me ndikim në zhvillimin e qëndrueshëm të industrisë së turizmit në bjeshkët

e Junikut. Sipas njoftimit të Komunës së Junikut, ky projekt po zhvillohet në kuadër të iniciativës "Shërbime të mira për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik". Projekti është financuar dhe mbikëqyrur nga Komuna e Junikut dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal.

## Në pikën kufitare në Vërmicë kapet mbi një kilogram drogë

Vërmicë, 14 tetor (ER) - Policia e Kosovës ka njoftuar se në pikën kufitare në Vërmicë, gjatë kontrollit të një veture me targa të

Shqipërisë në të cilën kishin qenë dy të dyshuar, shtetas të Shqipërisë, është gjetur dhe është konfiskuar një sasi e substancave

narkotike e llojit marijuanë me peshë 1 kilogram e 69 gramë. Përveç substancave narkotike, nga të dyshuarit është konfiskuar

vetura dhe dy telefona celularë. Të dyshuarit janë arrestuar dhe me vendim të prokurorit janë dërguar në mbajtje.



## E mbijetuara e dhunës seksuale dorëzon padi në Prokurorinë Speciale

PRISHTINË, 14 TETOR (ER) - E mbijetuara e dhunës seksuale nga koha e luftës në Kosovë, Shyrete Tahiri-Sylejmani, publikisht ka kërkuar drejtësi për ngjarjen që përjetoi gjatë kohës së luftës. Të hënën ajo ka dorëzuar në Prokurorinë Speciale të Kosovës kallëzimin penal për rastin e saj. Meqenëse është kërkuar nga prokuroria hetimi i

këtij rasti, detajet dhe përshkrimi i ngjarjes nuk do të publikohen. Guximi i Shyretës do të shërbejë si shembull për shumë të mbijetuara të tjera që t'i drejtohen Prokurorisë Speciale dhe t'i paraqesin rastet e tyre pa pasur nevojë që paraprakisht t'i ndajnë rrëfimet e tyre me publikun. Me këtë rast, ajo ka thënë se

këtë po e bën për ta ndarë dhimbjen që ka në shpirt. "Ju falënderoj për mbështetjen. Jam këtu për ta ndarë dhimbjen që kam në shpirt. Unë këtu përfaqësoj të gjitha nënat, gratë që kanë përjetuar dhimbjen. Nuk është e lehtë kjo", ka deklaruar Tahiri-Sylejmani. Shyhetja është me prejardhje nga Gjilani, por jeton në Kanada.



# Malisheva përkujton 15 maturantët që vdiqën tragjikisht në Fushë Arrëz

Të hënën në Komunën e Malishevës janë përkujtuar 15 maturantët e Gjimnazit "Abdyl Frashëri" që në vitin 2004 kishin humbur jetën tragjikisht gjatë kthimit nga ekskursioni

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

MALISHEVË, 14 TETOR - Data 14 tetor është data më e dhimbshme për Komunën e Malishevës pasi me këtë datë të vitit 2004 15 maturantë të Gjimnazit "Abdyl Frashëri", tani Gjimnazi "Hamdi Berisha", humbën jetën tragjikisht në Fushë-Arrëz gjatë kthimit nga ekskursioni në Shqipëri. Kjo ngjarje shënon edhe ngjarjen më tragjike në Kosovën e pasluftës. Në kujtim të kësaj tragjedie të

hënën janë bërë homazhe në varrezat e maturantëve në Malishevë. "Kjo është dita më e dhimbshme për të gjithë ne dhe ngjarja më e dhimbshme për të gjithë, pasi në këtë datë, 15 vjet më parë, ne humbën 15 djem të rinj, 15 maturantë. Ishte dëshira e zotit që ata të ikin nga kjo botë, të gjithë së bashku në një vend, prandaj edhe varrimi i tyre është bërë në një vend. Ishte ngjarja më e dhimbshme për ne të gjithë dhe ne gjithmonë do t'i kujtojmë", ka thënë kryetari i Komunës së



Malishevës, Ragip Begaj, në fjalën e tij drejtuar familjarëve të 15 maturantëve. Ndërsa ish-drejtori i gjimnazit, Januz Kastrati, në fjalën e tij ka thënë se ky përvjetor është i veçantë pasi përputhen dy numrat, numri i 15 maturantëve dhe numri i 15-vjetorit të ndarjes së tyre nga jeta. "Ishte përjetim i rëndë, sepse familjet humbën më të dashurit e tyre dhe ne humbën 15 maturantë, e Malisheva humbi 15 banorë të saj. Në gjithë këtë tragjedi ishte lehtësi

shpirtërore kur i sheh njerëzit që vinin nga të gjitha trojet shqiptare. Më lejoni që edhe sot t'jua përcjell ngushëllimet më të sinqerta të gjithë qytetarëve të Malishevës", ka deklaruar ish-drejtori i Gjimnazit "Abdyl Frashëri", Januz Kastrati. Më 14 tetor të vitit 2004, gjatë kthimit nga ekskursioni në Shqipëri, në një aksident trafiku humbën jetën, Berat Suka, Esat Hajrullahu, Elgadaf Zabelaj, Mifail Morina, Rifat Hoxha, Xhevdet Sertolli, Visar Kafexholli,

Agron Berisha, Ajet Rrahmanaj, Esat Rexhaj, Labinot Morina, Lulzim Kastrati, Megzon Sadiku, Ruhi Ulluri dhe Xhevdet Sahitaj, të gjithë maturantë të gjimnazit nga Malisheva. Të gjithë maturantët që humbën jetën në këtë tragjedi janë varrosur në "Lëndinën e Lotëve", afër lagjes së Gurit në Malishevë, ndërsa në kujtim të tyre është ngritur edhe një lapidar, ndërsa në Fushë-Arrëz, në vendin e aksidentit, është ngritur një obelisk në kujtim të ngjarjes.

## Kurti: Shqiptarët e Turqisë, urë e fuqishme për bashkëpunimin Kosovë - Turqi

PRISHTINË, 14 TETOR (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka pritur të hënën në takim ambasadorin e Turqisë në Kosovë, Çağrı Sakar. Ky i fundit ka uruar Kurtin për rezultatit zgjedhor dhe për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. Ambasadori turk ka pohuar se mbështetja e Turqisë do të vazhdojë dhe se me rëndësi është të zhvillohet një partneritet mes dy vendeve, sidomos në fushën e

ekonomisë dhe shëndetësisë. "Turqia, po ashtu, do ta ndihmojë dhe ta përkrahë anëtarësimin e republikës sonë në NATO dhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë", citohet të këtë thënë ambasadori turk sipas një njoftimi të LV-së. Ndërkaq Kurti ka falënderuar ambasadorin Sakar për mbështetjen e vazhdueshme të Turqisë, duke shprehur besimin se partneriteti mes dy republikave do të përparojë me qeverinë e re të

Kosovës. "Shqiptarët në Turqi mund të jenë një urë e fuqishme për bashkëpunim ekonomik në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Turqisë dhe me qeverinë e re do të shtrohet mundësia që kjo të ndodhë. Gjithashtu, në aspektin e shëndetësisë mund të bëhen përmirësime të ndjeshme, kurse në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë do ta forconte aleancën mes dy shteteve tona", ka thënë Kurti.



## Stoltenbergu bën thirrje për unitet në luftën kundër IS-it

**BRUKSEL, 14 TETOR** - Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg u bëri thirrje vendeve aleate të qëndrojnë unike në luftën kundër grupit ekstremist Shteti Islamik (IS). Ndarjet në aleancën ushtarake janë shfaqur pasi Turqia, si anëtare e NATO-s, filloi ofensivën e saj në Siri, gjatë javës së kaluar. Qeveritë e disa vendeve të BE-së e kanë kërcënuar me sanksione Ankaranë. "Ne nuk duhet t'i rrezikojmë arritjet që kemi bërë kundër

armikut tonë të përbashkët", tha sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg. "Turqia është e rëndësishme për NATO-n. Ne rrezikojmë të dëmtojmë unitetin që na nevojitet në luftën kundër Shtetit Islamik", tha Stoltenberg. Ofensiva turke në veri të Sirisë kundër luftëtarëve kurdë, po kritikohet në masë të madhe. Kurdët e Sirisë kanë qenë aleatë të Perëndimit në luftën kundër militantëve të IS-it, mirëpo Turqia i konsideron ata terror-

istë. Ankaraja zyrtare po synon krijimin e një zonë të sigurt në veri të Sirisë, në mënyrë që, siç thotë, të kthejë miliona refugjatë siri-anë që gjenden në territorin turk. Autoritetet turke kanë kërcënuar vendet evropiane se mund t'i hapin portat dhe t'i drejtojnë këta refugjatë për në vendet evropiane. Kancelarja gjermane, Angela Merkel ka kërkuar "ndërprerjen e menjëhershme të operacionit ushtarak" të Turqisë në Siri.



# Forcat siriane dhe ato kurde avancojnë drejt kufirit me Turqinë

Trupat siriane dhe ato kurde kanë hyrë në Tal Tamr, rreth 20 kilometra nga kufiri, me qëllim të konfrontimit me agresionin e turqve, lëvizje këto të mirëpritura nga banorët

**PRISHTINË, 14 TETOR** - Një ditë pas marrëveshjes së arritur midis forcave siriane dhe atyre kurde për të lëvizur drejt kufirit me Turqinë, forcat siriane hynë në një qytet pranë kufirit turk, duke filluar kështu zbatimin në terren të saj. Ndërkohë presidenti amerikan Donald Trump akuzoi në një postim në Twitter forcat kurde, se po lirojnë luftëtarët e ISIS-it nga burgjet, që të nxisin përfshirjen e Shteteve të Bashkuara në luftime. Ai vazhdon ta quajë një lëvizje të mençur, tërheqjen e trupave amerikane nga veriu i Sirisë ndërsa paralajmëron sanksione të mëdha për Turqinë. Nga ana tjetër, presidenti francez Emmanuel Macron dhe kancelarja gjermane Angela Merkel, shprehën domosdoshmërinë e koordinimit për të ndaluar Turqinë të shkaktojë atë që ata e quajnë situatë të papërbalueshme humanitare, ka njoftuar voa.

Agjencia shtetërore siriane e lajmeve SANA, raportoi për hyrjen e trupave siriane dhe kurde në Tal Tamr, rreth 20 kilometra nga kufiri, me qëllim të konfrontimit me agresionin e

turqve, lëvizje këto të mirëpritura nga banorët.

Marrëveshja midis kurdëve, sirianëve dhe rusëve që janë aleati kryesor i Sirisë, erdhi katër ditë pas operacionit të forcave turke kundër kurdëve në veri të Sirisë, pasi ShBA tërhoqi pothuajse të gjitha trupat nga vendi. Turqia i sheh luftëtarët kurdë si terroristë të lidhur me separatistët në Turqi. Ndërhyrja ushtarake ka shkaktuar viktima civile. Por ky nuk është problemi i vetëm i shkaktuar nga konflikti.

Rojet kurde të burgjeve, për shkak të luftimeve po lënë pa mbikëqyrje luftëtarët e ISIS-it, një pjesë e të cilëve veç kanë ikur nga kampet ku po mbaheshin bashkë me familjet e tyre, thonë zyrtarët e kurdëve sirianë.

Por, këto deklarata duket se nuk e kanë bindur presidentin amerikan, Donald Trump, i cili akuzoi kurdët për lirim të pjesëtarëve të ISIS-it.

"Kurdët mund t'i lirojnë disa, sa për të na përfshirë neve. Lehtësisht mund të rikapen nga turqit ose vendet evropiane prej nga kanë ardhur, por duhet veprim i shpejtë. Po vijmë sank-



sione të mëdha për Turqinë! A mendojnë vërtet njerëzit se ne duhet të hyjmë në luftë me anëtarin e NATO-s, Turqinë? Luftëtar që nuk kanë fund do të përfundojnë", shkroi presidenti Trump në llogarinë e tij në Twitter. Presidenti Trump tha se "të njëjtët njerëz që përfshinë Shtetet e Bashkuara në kaosin e Lindjes së Mesme, janë ata që po kërkojnë nga ne të qëndrojmë atje". Ai akuzon gjithashtu vendet e Evropës se provuan t'ia faturojnë Shteteve të Bashkuara çmimin e kthimit të luftëtarëve të ISIS-it, të cilët thotë se kanë mundur deri tani t'i marrin në vendet e tyre. Ndërkohë, presidenti francez, Emmanuel Macron dhe kancelarja gjermane, Angela Merkel thanë

në një konferencë të përbashkët se Turqia rrezikon të shkaktojë një krizë të papërbalueshme humanitare.

"Në njërin anë, kjo ofensivë rrezikon të krijojë një krizë humanitare, të cilën veç mund ta shohim. Në anën tjetër, rrezikon të ndihmojë rishfaqjen e Shtetit Islamik në rajon. Ashtu siç e njoftuam Turqinë se ne do ta ndërpresim shitjen e armëve, vazhdojmë të jemi të koordinuar për nisim të tjera në orët dhe ditët në vazhdim", tha presidenti francez Emmanuel Macron.

"Sot bisedova për një orë me presidentin Erdogan. Sigurisht duhet të kemi në konsideratë interesin e Turqisë për siguri, por gjithashtu mendojmë se duhet të

pengojmë ndërhyrjen turke, për arsye humanitare. Nuk mund ta pranojmë këtë situatë, prandaj duhet të gjejmë zgjidhje", tha kancelarja gjermane, Angela Merkel.

Kurdët thonë se ndihen të braktisur nga Shtetet e Bashkuara, pasi luftuan krah për krah me forcat amerikane kundër ekstremistëve të Shtetit Islamik në Siri. Ata besojnë se bota arabe dhe Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara po i injoron.

Presidenti Trump tha se po punon me udhëheqësit e Kongresit, duke përfshirë edhe demokratët e opozitës, në vendosjen e sanksioneve të fuqishme ekonomike kundër Turqisë.

## Konservatorët sigurojnë edhe një mandat në Poloni

**VARSHAVË, 14 TETOR** - Partia konservatore në pushtet, Ligji dhe Drejtësia, është fituese e shumicës në zgjedhjet parlamentare të së dielës në Poloni, duke siguruar kështu edhe një mandat katërvjeçar për të vazhduar reformat që çuan në përplasje me Brukselin.

Sipas rezultateve paraprake, kur janë numëruar mbi 90 për qind të votave, kjo parti ka siguruar 44.6 për qind të tyre.

Koalicioni Qytetar, grupimi më i madh opozitar ka fituar 26.7 për

qind të votave i pasuar nga aleanca e majtë me 12.3 për qind.

Fitorja e partisë Ligji dhe Drejtësia, ka të ngjarë të ngjallë shqetësime për standardet demokratike në shtetin më të madh ish-komunist të Bashkimit Evropian, qeveria e të cilit është akuzuar për politizimin e gjyqësorit, shndërrimin e medieve shtetërore në zëdhënës të saj dhe polarizimin e shoqërisë.

Një mandat i dytë për këtë parti gjithashtu mund t'i forcojë pop-

ulistët kundër emigracionit në Bashkimin Evropian, të cilat i kundërvihen agjendës liberale të bllokut.

Kritikët e akuzuan atë për nxitje të homofobisë gjatë fushatës zgjedhore, me zyrtarët e saj që i cilësuan të drejtat e komunitetit LGBT një ndikim të huaj pushtues që kërcënon identitetin kombëtar të Polonisë. Votimet e së dielës konsiderohen si zgjedhjet më të rëndësishme në Poloni që nga rënia e komunizmit 30 vjet më parë.





## AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla  
"RITMO - L"  
Prishtinë**

**Eksperiencia jonë  
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:  
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:**

**044 248 173**

**044 200 604**

**044 375 333**

**E jashtëzakonshme**

# Anija më e madhe që kalon në ngushticën më të vogël

Vetëm një metër e ndante anijen nga secila anë dhe udhëtarët mund ta zgjasnin dorën e t'i kapnin shkëmbinjtë. Anija MS Bramear është 195 metra e gjatë, 22 metra e gjerë dhe mund të mbajë 1 200 udhëtarë në bord bashkë me ekuipazhin. Kanali i Korintit është 6.4 kilometra i gjatë dhe 24 metra i gjerë dhe



ndan Greqinë nga Gadishulli i Peleponezit. Pamjet fantastike treguan se si anija e përshkoi kanalën duke pasur shumë pak hapësirë nga të dy krahët.

**FOTO E DITES**



Varkat me vela marrin pjesë në edicionin e 51-të të Festivalit Tradicional "Barcolana" në gjirin e Trieste. /AP/

**E rrallë**

# Gjen motoçikletën e vjedhur para 28 vjetësh

Disa thonë se drejtësia në Itali vonon, por 28 vjet për të gjetur një skuter të vjedhur mund të duket pak e tepërt. Karabinierët në provincën e Ferraras, në jug të Venecias, zbuluan një motoçikletë të tipit "Vespa Piaggio 50", që ishte vjedhur nga një i ri në vitin 1991. Një biznesmen i moshës 44-vjeçare u akuzua për këtë. Policia



gjeti skuterin në momentin kur biznesmeni u përpoq ta regjistronte atë.

**BARSOLETA E DITËS**



- Qysh bre s'të vjen marre t'i ndihmosh gruas me përgatit bukën?
- Asgjë të keqe nuk ka këtu!
- Qenke lig shumë.
- Edhe ajo po më ndihmon t'i laj enët!



**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Çdo ditë në ora 16:00  
Toy Story 4 / 3D**

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

**Rolet:** Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Madeleine McGraw (Bonnie), Christina Hendricks (Gabby Gabby), Don Rickles (Mr. Potato Head), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.

**Regjia:** Josh Cooley




**Në ora 18:00 dhe 20:00**

**AD ASTRA**

Aventurë/Dramë/Mister; 2 orë 04 min

**Rolet:** Brad Pitt, Tommy Lee Jones, Ruth Negga, Liv Tyler, and Donald Sutherland

**Regjia:** James Gray



**Çdo ditë në ora 22:00**

**DOWNTON ABBEY**

Dramë; 2 orë 02 min

**Rolet:** Hugh Bonneville, Jim Carter, Michelle Dockery, Elizabeth McGovern, Maggie Smith, Imelda Staunton, Penelope Wilton, etj.

**Regjia:** Michael Engler

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**




**DASHI**

Dita do të nisë me shkrimet që lidhen me krijimin ose projektet që kanë të bëjnë me komunikimin.



**DEMI**

Ju jeni person që e vlerësoni shumë familjen dhe rrallë mund të mendoni të kundërtën.



**BINJAKET**

Disa libra që ju duken interesantë po ndryshojnë jetën tuaj në disa mënyra.



**GAFORRJA**

Zakonisht ju besoni instinktet tuaja për paratë, por sot besoni më shumë logjikën.



**LUANI**

Një mik ose një grup me të cilin qëndroni mund të jetë duke ndryshuar jo vetëm personalitetin tuaj, por edhe jetën.



**VIJGJËRESHJA**

A keni qenë duke menduar që të ndryshoni punë ose të provoni një profesion të ri? Nëse është kështu, sot është dita për ta provuar.



**PESHORJA**

Mund të pësoni një transformim radikal të rutinës së përditshme.



**AKREPI**

Sot mund të sulmohen vlerat tuaja. Ndoshta një koleg në punë mund të bëjë gjëra që nuk ju duken etike dhe nuk doni të jeni më pranë tyre.



**SHIGJETARI**

Ditën e sotme do ta kaloni duke u kujdesur me ortakëri, qofshin këto personale apo pune.



**BRICJAPI**

Sot do të përqendrohni te hulumtimi në fushat e paqarta të punës suaj.



**UJORI**

Do të keni një ditë fantastike. Ju do të kryeni çdo detyrë që ju kërkohet dhe jeta në çift sot do të jetë shumë e zjarrtë.



**PESHQIT**

Disa punë që lidhen me infrastrukturën e shtëpisë suaj duhet të përfundohen sot.

## Mohamed Salah shpallet "Burri i vitit 2019"



**M**ohamed Salah është ylli i coverit të këtij muaji të revistës për burra 'GQ'. Futbollisti i Liverpoolit u shpall "Burri i vitit 2019" nga revista 'GQ'. "Të gjitha ëndrrat dhe qëllimet e mia ishin të bëhesh një profesionist i njohur, por nuk e imagjinoja se do të arrija në nivelin që jam tani", ka


thënë Salah. Ai ka pozuar për kopertinën e revistës me supermodeluesen Alessandra Ambrosio. Salah mundi kandidatët e tjerë, shokun e skuadrës së Liverpoolit, Sadio Mane dhe sulmuesin e Arsenalit, Pierre-Emerick Aubameyang. Ndërkohë ylli i 'Victoria Secret' Alessandra Ambrosio fitoi "Fashion Icon".

## Ylli i K-Pop gjendet e vdekur në banesë në moshën 25-vjeçare



**Y**lli i K-pop, Sulli, është ndarë nga jeta në moshën 25-vjeçare. Këngëtarja u gjet e vdekur nga menaxherja e saj brenda në banesë në Seul, Korenë e Jugut. Policia po heton shkakun e vdekjes së Sullit. Nuk përjashtohet mundësia që ka vrarë veten. Ylli

korean, që ka më shumë se pesë milionë ndjekës në "Instagram", ishte anëtare e grupit F(x) derisa u largua në vitin 2015 për t'u përqendruar në karrierën e saj në aktrim. Sulli ishte shoqe e ngushtë e yllit të K-Pop, Jonghyun, që vrau veten në moshën 27-vjeçare në vitin 2017.




## Bebe Rexha pranon ofertë bashkëpunimi nga idhulli i saj

**K**ëngëtarja me origjinë shqiptare, Bebe Rexha, ka bërë me dije se ka pranuar ofertë bashkëpunimi nga këngëtarja Dolly Parton. Me këtë rast, Bebe Rexha ka zbuluar se Dolly Parton është edhe një nga idhujt e saj. Përmes një postimi në

"Instagram", Bebe dhe Dolly ndajnë mendimin e përbashkët për të sjellë një këngë. "Po vdes. Ajo është një nga idhujt e mi. Shikojeni atë. Ai është qëllimi im. Ndoshta një bashkëpunim?", ka shkruar Bebe Rexha në përshkrimin e një videomesazhi të Dollyt.

## DMX anulon koncertet dhe i rikthehet rehabilitimit



**R**eperi 48-vjeçar Earl Simmon, i njohur si DMX, ka bërë me dije përmes "Instagram"-it se i ka anuluar koncertet e ardhshme. Në angazhimin e tij të vazhdueshëm për ta vendosur në prioritet familjen dhe të qëndruarit esëll, DMX e ka

regjistruar veten në një institucion rehabilitimi. Ai ka kërkuar falje për koncertet e anuluar dhe i ka falënderuar fansat për mbështetjen e vazhdueshme. DMX ishte planifikuar të performojë në festivalin Rolling Loud në Nju Jork.







# Tri vlerat më të mira të hideve për trup të shëndetshëm

Hidet janë kultivuar në tokë prej më shumë se 4000 vitesh.

Hidet janë të pasura me një sërë vitaminash, minerale por edhe antioksidantësh.

Në variantin e tyre të thatë, hidet kanë gjetur përdorime të larmishme në mjekësinë popullore.

Ato janë përdorur prej shekujsh kundër alergjive, tensionit të lartë, dhimbjeve, problemeve me frymëmarrjen dhe stresit.

Një nga vlerat më të mëdha të hideve është për njerëzit që kanë të vështirë të bëjnë një gjumë cilësor.

E gjithë pema e hideve ka vlera natyrale terapeutike dhe qetësuese duke nxitur gjumin, ulur stresin dhe larguar ankthin.

## Roli i hideve për gjumin dhe qetësinë

Sicc e thamë edhe më lart, hidet janë të pasura me vitamin dhe minerale të cilat i japin organizmit shumë përfitime.

Antioksidantët tek hidet, veçanërisht saponina dhe flavonoidet, nxisin disa ndryshime në transmetuesit nervorë, përfshirë këtu tek serotoninina.

Ky hormon është thelbësor dhe ndihmon që njeriun ta zëjë gjumi por edhe të flejë pa ndërprerje gjatë natës.

## Hidet kundër sheqerit në gjak

Hidet mund të ulin nivelin e lartë të sheqerit në gjak. Kësisoj këto fruta janë të rekomanduara për njerëzit që vuajnë nga diabeti apo ccrregullime të tjera metabolike.

Ekspertët mendojnë se ky rol i hideve kundër sheqerit të lartë, i atribuohet nivelit të lartë të vitaminës A e cila përmirëson ndjeshmërinë ndaj insulinës.

Hidet ndikojnë edhe në sekretimin e një hormoni që rregullon nivelin e glukozës në gjak.



## Hidet për tretjen

Ekspertët këshillojnë që njerëzit që kanë probleme me tretjen të hanë rregullisht hiden.

Ato janë përdorur prej mijëra vitesh kundër problemeve me tretjen, dhimbjeve të stomakut, fryrjet dhe konstipacionin.

Studimet të cilave u referohet AgroËeb.org thonë se hidet pakësojnë acidin gastrik dhe

mbrojnë stomakun nga ulcera.

## Ndërveprimi i hideve me medikamente të caktuara

Këto fruta mund të kenë një reagim negativ në organizëm për shkak të ndërveprimit me barna të caktuara.

Për shembull, hidet ndërveprojnë negativisht me ilacitet

kundër diabetit. Nëse një diabetik merr barna për uljen e nivelit të sheqerit në gjak, duhet të tregojë kujdes me hidet sepse ulja e sheqerit mund të jetë e dyfishtë dhe më e madhe secc duhet.

Hidet dhe barnat për qetësim nuk duhet të merren në të njëjtën kohë sepse mund t'ju mbajnë të përgjumur për shumë gjatë./AgroWeb

# Produkti që ju ndihmon të keni muskuj të fortë - dozat që duhet të konsumoni

Muskujt e fortë janë çelësi për një organizëm të shëndetshëm dhe plot jetë.

Kur përjetoni dhimbje dhe dobësim të tyre, çdo veprim në jetën e përditshme bëhet më i vështirë.

Ndaj rëndësia e shmangies së probleme muskulore, përveçse është një problem shëndetësor, mund të kthehet edhe në një bezdisje të madhe.

Shëndeti i tyre fillon që nga aktiviteti fizik, ushqimet dhe suplementet e ndryshme.

Në këtë artikull AgroWeb.org ju tregon një prej tyre që do të rrisë forcën dhe shëndetin e muskujve tuaj.

## Çfarë i forcon muskujt

Përgjigjja për këtë pyetje ndodhet me shumë siguri në kuzhinat tuaja.

I pasur me hekur, kalcium dhe magnez 'superushqimi' që ju duhet për të forcuar muskujt tuaj është spinaqi.

Megjithëse prej shumë kohësh tashmë vetitë e spinaqit janë të

njohura, mjekët e rekomandojnë tashmë si mënyrën më të mirë për të forcuar organizmin dhe muskujt.

Ekspertët thonë se, të gjithë punën në këtë drejtim e bën vetëm një suplement që ndodhet tek spinaqi.

Ekdisteroid quhet suplementi bazë që rrit performancën dhe forcën e muskujve dhe që gjendet me shumicë tek spinaqi.

Të dhënat e marra nga 46 atletë treguan se ata që konsumuan më shumë ekdisteroide gjatë 10 javëve treguan një përmirësim fizik.

Siç përmendëm edhe më sipër spinaqi është ndër ushqimet që e e përmbajnë me shumicë këtë suplement të rëndësishëm.

## Sa duhet të konsumoni

Për të parë rezultate të menjëherëshme tek muskujt tuaj dhe për t'i bërë ata më rezistentë konsumoni spinaq.

Ekspertët rekomandojnë një sasi sipër 250 gr në ditë në mënyrë që të mund të merrni sasi të duhura të ekdisteroideve.

Praktikojeni dietën me spinaq për



10 javë rresht duke e bërë atë pjesë shoqëruese të vakteve tuaja.

Për të përfutur shëndet të plotë të muskujve dhe për të shpëtuar nga

shumë sëmundje që i prekin ato./AgroWeb

# Mandarinat e gjelbra shqiptare - fuqitë e forta natyrore kundër problemeve shëndetësore

Shumëkush i preferon mandarinat e gjelbra me një shije të thellë, të thartë të ëmbël në të njëjtën kohë

Ato janë bujare duke na dhënë vitaminën e nevojshme C për sistemin imunitar, i cili na ndihmon të luftojmë ftohjet, virozat dhe gripin.

Shqipëria është me fat që ka agrume nga më cilësoret. Në këto ditë, të parat që kanë dalë në treg janë mandarinat gjysëm të gjelbra.

Duke qenë se janë mandarinat e para të sezonit, ato nuk janë të pjekura plotësisht dhe shija e tyre dominohet nga athtësia.

**Të mira për kontrollin e sheqerit, shëndetin e mëlçisë dhe presionin e gjakut**

Mandarinat e gjelbra janë një lajm i mirë për ata që kontrollojnë sasinë e sheqerit natyral që marrin nga frutat. Sidomos për diabetikët e tipit 1 dhe 2, mandarinat e gjelbra janë një zgjidhje ideale.

Gjithashtu athtësia e mandari-



nave të gjelbëra është e jashtëzakonshme për shëndetin e mëlçisë apo për përmirësimin e tretjes.

Antioksidantët që gjenden tek mandarinat, ulin kolesterolin e keq dhe largojnë radikalalet e lira nga organizmi. Shumë të pasura me fibra, mandarinat lehtësojnë rënien në peshë.

Nëse konsumoni mandarina të

gjelbra rregullisht, tensioni juaj i gjakut do të jetë më i ekuilibruar. Vitamina C tek ky frut plot shije lufton të ftohtin e gripin dhe forcon imunitetin.

**Përfitimet kundër plakjes së parakohshme**

Vitaminës C i thurin shumë lavde kur vjen puna tek roli i saj

në sistemin imunitar.

Por roli i kësaj vitamine është shumë i çmuar në prodhimin e kolagenit që ndihmon në mbrojtjen e qelizave nga dëmet e shkaktuara prej ndotjes së mjedisit.

Lexoni më poshtë rekomandimin e AgroWeb.org se si thjeshtësisht mund të kombinoni agrumet më të mira të

stinës për një lëng që ju jep shije dhe shumë shëndet të mirë.

**Përbërësit:**

- 3 mandarina të gjelbra
- 1 limon i verdhë
- 2 kërcenj selinoje
- 4 gjethe spinaqi

**Udhëzimet për përgatitjen në shtëpi**

Lajini produktet me ujë të rrjedhshëm

Qëroni mandarinat dhe limonët. Hidhni të gjithë përbërësit në një shtrydhëse frutash dhe shijoni lëngun dhe mushtin e tyre

**Produkte të tjera zëvendësuese**

Mandinën mund ta shoqëroni edhe me portokallin ose karrotën. Limonin e verdhë mund ta këmbeni me qitron, e cila sjell shumë përfitime për shëndetin. Selinonë mund ta zëvendësoni me kunguj të vegjël ose një a dy tufa me majdanos të freskët. Spinaqin mund ta zëvendësoni me fletë sallata jeshile, marule ose pazi. /AgroWeb

## Kura dy ditore me farat e shalqinit për pastrimin rrënjësor të veshkave

Lëngu me farat e shalqinit konsiderohet të jetë një kurë që ndihmon në pastrimin e veshkave.

Ky lëng mund të përdoret dhe për të parandaluar dhe eliminuar krijimin e gurëve në veshka.

Është i lehtë për t'u përgatitur dhe kërkon vetëm dy përbërës që në këtë stinë mund të gjenden fare lehtë.

Më poshtë do të mësoni nga AgroWeb.org mënyrën e përgatitjes së kësaj kure si dhe përdorimin e saj.

**Përgatitja e lëngut me fara shalqini**

Rekomandohet që të përgatitet 2 litra nga ky lëng për t'u konsumuar përgjatë një periudhe 1-2 ditore.

Ato çfarë ju nevojitet janë 4 lugë me fara shalqini dhe tetë gota me

ujë.

Farat e shalqinit mund t'i mblidhni herën tjetër që do të bliji këtë frut.

E vetmja gjë që duhet të keni parasysh është që farat nuk duhet të jenë të thara.

Pasi t'i keni shpëlarë më ujë të bollshëm mund t'i bluani përmes grirësës elektrike, ose me mullirin e kafesë.

Në një tenxhere hedhim ujin dhe e lëmë që të vlojë. Më pas në një enë qelqi ku kemi vendosur farat e bluara të shalqinit, shtojmë ujin që ka vluar.

I lëmë farat e shalqinit në ujë rreth 10-15 minuta, në këtë mënyrë ato kanë lëshuar të gjithë vajin që përmbajnë.

Më pas, AgroWeb.org ju këshillon të kulloni masën duke mbajtur vetëm lëngun. Pasi ai të jetë ftohur paksa mund ta vendosim

dhe në frigorifer.

**Si ta konsumoni?**

Dy litrat e lëngut të farave të shalqinit mund të pihet për një periudhë një deri në dy ditore. Ditën e tretë ju duhet të bëni pushim nga kjo kurë. Zakonisht sugjerohet që të pihen katër gota për çdo ditë.

**Efektet në organizëm**

Ky lëng është përdorur për shekuj të tërë për të kuruar personat që kanë pasur probleme me veshkat.

Farat përmbajnë disa enzima dhe vajra të cilët ndihmojnë në eliminimin e toksinave të mbledhura në veshka.

Duke arritur këtë proces ai parandalon formimin e kristaliz-



imeve të kripërave të cilat më pas rezultojnë në gurë që bllokohen në funksionin e tyre.

Një tjetër efekt që ky lëng ka, është dhe balancimi i presionit të gjakut.

Farat e shalqinit përmbajnë disa minerale që ndihmojnë në qarkullimin e gjakut dhe zhblokohen venat nga papastërtitë, kështu që ulin presionin e lartë të gjakut. /AgroWeb

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

# Kosova vazhdon sigurt rrugëtimin drejtë 'Euro 2020'

Shkëlqimi i futbollistëve 'dardanë' në stadiumin 'Fadil Vokrri' dhe në kualifikimet për Kampionatin Evropian vazhdoi edhe të hënën në mbrëmje kur e mposhtën Malin e Zi (2-0). Kosova vazhdon të jetë kandidat serioze për kualifikim në 'Euro 2020', por për të arritur një gjë të tillë i duhet të shkëlqen edhe në dy finalët e fundit ndaj Çekisë dhe Anglisë



**GRUPI A**

Bullgari - Angli	0-6
Kosova - Mali i Zi	2-0

**Tabela**

	PIKË
1. Anglia	6
2. Çekia	6
3. Kosova	6
4. Mali i Zi	3
5. Bullgaria	3

grumbulluar 11 pikë, kurse Mali i Zi mbetet me 3 pikë dhe zë vendin e fundit në renditjen tabelore.

**EPOKA ERE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 14 TETOR** - Përfaqësuesja e Kosovës e vazhdon sigurt rrugën drejtë kualifikimit në Kampionatin Evropian, pasi e mposhti të hënën në mbrëmje me lojë dhe rezultat Malin e Zi (2-0), në ndeshjen që u zhvillua në stadiumin "Fadil Vokrri". "Kemi pasur pak presion, por kemi luajtur mirë. Kemi mbajtur topin. Ishte lojë shumë e mirë, taktikisht dhe mentalisht. Duhet të jemi pozitivë, më agresivë", ka thënë pas ndeshjes Bernard Challandes, përzgjedhës i Kosovës. Vetëm dhjetë minuta janë mbajtur malazezët, pasi porta e tyre me pas u vërshuar nga goditjet e futbollistëve të Kosovës. Fillimisht provoi Aliti, por pa sukses. Më pas një goditje nga këndi që e ekzekutoi për mrekulli Celina, në zonën e rreptësisë Amir Rrahmani u shkëput me se larti dhe me kokë shënoi për 1-0. Tre minuta me vonë provon edhe Rashica, por aksioni nuk përfundoi suksesshëm. Në minutën e

**Kosova - Mali i Zi 2-0**  
Stadiumi "Fadil Vokrri"  
Shikues: 12 949  
Shënues: Amir Rrahmani (10), Vedat Muriqi (34)  
Gjyqtarë: Artur Manuel Ribeiro Soares Dias (Portugali)  
Kartonë të verdhë: Muriqi, Vojvoda, Kololli (Kosova), Jovoviq, Scekiq, Vukçeviq, Jankoviq (Mali i Zi).  
Kosova: Muriq, Vojvoda (Zhegrova), Rrahmani, Aliti, Kololli, Shala (Rashkaj), Berisha, Celina (Hasani), Hadergjonaj, Rashica, Muriqi.  
Mali i Zi: Petkoviq (Mijatoviq), Bulatoviq, Vukçeviq, Lagator, Mugosa, Jovoviq, Kosoviq, Sqekiq, Boljevqi, Simiq, Mursiq.

15-të, Mali i Zi bëri ndryshimin e parë ku portieri Petkoviq lëshoi fushën pas një lëndimi dhe në vend të tij u inkuadrua Mijatoviq. Mysafirë provuan nga ndërprerja pa ndonjë sukses. Më pas Rashica e Muriqi nuk arritën të dyfishojnë rezultatin, kurse në anën tjetër edhe Boljevqi dështoi të befason portierin e Kosovës, Arijanet Muriq. Në minutën e 34-

të, Vedat Muriqi pas dy tentimeve e shënoi golin e dytë për "Dardanët". Edhe pjesa e dytë ishte dominuese nga Kosova, e cila pavarësisht rasteve të panumërta nuk arriti të shënon golin e tretë. Në minutën e 50-të, Milot Rashica gjuajti jashtë portës se portierit malazez. Tre minuta me pas, Simiq u mundua të kundërpërgjigjet, por pa ndonjë rrezik të madh për Kosovën. Kur po kalonte një ore lojë, anësori Mërgim Vojvoda harkon për mrekulli deri të Hadergjonaj, i cili nuk arriti të shtyjë topin në rrjetën e portierit Mijatoviq. Në minutën e 69-të, Muriqi goditi shtyllën dhe nga topi i rikthyer shënoi Celina, por goli ishte i parregullt përshkak të pozitës jashtëloje. Në vijim të ndeshjes ishin edhe disa raste nga futbollistët e Kosovës, por ndeshja përfundoi me rezultat 2-0. Pas kësaj fitore, Kosova është e treta dhe ka

## Shqipëria deklasoi Moldavinë

Shqipëria ka marrë një fitore të pastër 0-4 në transfertë ndaj Moldavisë në ndeshjet e vlefshme për eliminatorët e "Euro 2020". Do të duhet të kthehem shumë kohë pas për të gjetur një pjesë loje si ajo 45 minutave në Moldavi për Kombëtaren shqiptare, e cila arriti të realizojë 3 gola. Ajo që është më e rëndësishme në këtë fazë të eliminatorëve, është rikthimi i besimit dhe mbi të gjitha i lojës së bukur të kuqezinjve. Reja ka rikthyer besimin. I përhershmi Sokol Cikalleshi shënoi në minutën e 22-të, duke zhbllokuar rezultatin, ndërsa Keidi Bare dyfishoi në minutën e 34. Më pas, ishte



radha e debutuesit Lorenc Trashi të shënojë një gol mjaft të bukur. Edhe në pjesën e dytë, kuqezinjët e drejtuar nga Reja zhvilluan një lojë të mirë dhe qershia mbi tortë erdhi nga Manaj në minutën e fundit të kohës së rregullt. Me këtë fitore, Shqipëria shkon në kuotën e 12 pikëve në vendin e katërt. Në ndeshjet e tjera të këtij grupi, Francë-Turqi u mbyll 1-1, ndërsa Islandë-Andorra 2-0.

# Përballje shqiptarësh në 'Elbasan Arena'

U21-shat e Shqipërisë dhe të Kosovës përballen sonte, me fillim nga ora 19:00, në kuadër të kualifikimeve për Kampionatin Evropian, në stadiumin 'Elbasan Arena'. Pavarësisht se është një ndeshje vëllazërore, meqë të gjithë futbollistët në fushë do të jenë shqiptarë, në asnjërin kamp nuk mendojnë gjë tjetër përveç fitores. Sherif Kallaku nga kombëtarja e Shqipërisë dhe Eris Abedini e Mirlind Daku nga përfaqësuesja e Kosovës kërkojnë pikët maksimale në ndeshjen emocionuese për të gjithë shqiptarët

**EPOKA ERE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 14 TETOR** - Kombëtarja e Shqipërisë U21 dhe përfaqësuesja e Kosovës përballen sonte (e martë) në "Elbasan Arena" në kuadër të kualifikimeve për Kampionatin Evropian. Futbollisti i Kosovës, Eris Abedini, ka thënë se kjo ndeshje është krejt ndryshe si për Kosovën, po ashtu edhe për Shqipërinë, pasi në fushë të gjithë do të jenë vëllazër të një kombi. Ai ka shprehur optimizëm se "Dardanët" do të dalin fitues në këtë ndeshje dhe do ta vazhdojnë

rrugëtimin drejt kualifikimit në Evropian. "Është një ndeshje ndryshe nga të tjerat, ngaqë në fushë të gjithë do të jemi vëllazër të një kombi. Mirëpo kjo nuk na intereson, pasi e kemi një objektivi para vetes për ta fituar ndeshjen dhe për ta vazhduar ëndrrën e kualifikimit në evropian. Sigurisht se do të jetë ndeshje e vështirë dhe Shqipëria do ta japë maksimumin, por ne synojmë ta bëjmë lojën tonë dhe shpresoj që gjithçka të shkojë siç duhet. Mendoj se pika jonë e fortë është fakti që luajmë me zemër, kemi cilësi dhe e lëmë shpirtin në fushë për 90 minuta",

ka thënë Abedini. Edhe futbollisti i skuadrës së Kukësit, Mirlind Daku, e konfirmon se Kosova synon fitoren në ndeshjen ndaj Shqipërisë. Sulmuesi e pranon se ndeshja do të jetë shumë emocionuese për faktin se të dyja skuadrat janë shqiptare. "Duke pasur parasysh se jemi dy kombëtare shqiptare, normalisht se do të jetë ndeshje emocionale për të dyja palët. Sigurisht se do të jetë ndeshje shumë e fortë, por besoj se do të ketë korrektësi maksimale. Ne duhet të hyjmë si në çdo ndeshje tjetër, me motiv të plotë për të fituar. Prioritet për ne



është arkëtimi i tri pikëve të reja në mënyrë që ta ndjekim ëndrrën e kualifikimit. Ka lojtarë që i njoh te Shqipëria, por i besoj shumë këtij grupi të futbollistëve dhe jam i bindur se do të arrijmë fitore", ka thënë Daku. Për ndeshjen që zhvillohet sonte nga ora 19:00 foli edhe kapiteni i Kombëtares së Shqipërisë, Sherif Kallaku. Ky i fundit ka thënë se nuk e sheh ndeshjen si vëllazërore, pasi një gjë e tillë nuk vlen brenda 90 minuta, por vetëm pas përfundimit të ndeshjes. "Ata kanë më shumë pikë se ne, por duhet ta shikojmë

thjesht si një ndeshje të radhës, ku duhet t'i marrim tri pikët. Për ne është detyrim. Lideri i skuadrës? Të gjithë, të 11 lojtarët, jemi liderë. Kosova, një derbi apo ndeshje vëllazërore? Nuk do të futemi si në një ndeshje vëllazërore, por për ta fituar. Është një derbi ku gjëra të tipit 'jemi vëllazër' nuk vlejné brenda 90 minutave. Pas ndeshjes jemi vëllazër dhe rrimë së bashku", ka deklaruar Kallaku.

**GRUPI 3**

19:00 Shqipëria U21 - Kosova U21  
20:45 Anglia U21 - Austria U21

**Tabela**

	PIKË
1. Austria U21	3
2. Anglia U21	2
3. Kosova U21	3
4. Turqia U21	5
5. Shqipëria U21	4
6. Andorra U21	3

## Muriqi: Nuk largohem nga Fenerbahçe

STAMBOLL, 14 TETOR - Tottenham Hotspuri vazhdon të jetë i interesuar për transferimin e sulmuesit Vedat Muriqi, por ky i fun-

dit është i vendosur të mos largohet nga Fenerbahçe edhe dy vjet. Sulmuesi i Kosovës në verë nga Caykur Rizesportin iu bashkua

Fenerbahçes dhe forma e mirë që po kalon ka ndikuar që ai të jetë në "radar" të shumë klubeve evropiane. "Do të qëndroj

të paktën edhe dy vjet në Fenerbahçe. Ende kam mangësi. Dua të shkoj në Evropë si një sulmues me klasë", ka deklaruar Muriqi.



## FFK-ja nënshkruan marrëveshje të rëndësishme me DFB-në



PRISHTINË, 14 TETOR - Federata e Futbollit e Kosovës dhe Federata e Futbollit e Gjermanisë kanë nënshkruar të hënën marrëveshjen gjithëpërfshirëse të bashkëpunimit, e cila, ndër të tjera, përfshinë shkuarjen e ekipeve kombëtare të grupmoshave të reja në kampet e Gjermanisë si dhe edukimin e gjyqtarëve, trajnerëve dhe administratorëve të FFK-së.

Marrëveshja u nënshkrua nga kryetari i FFK-së, Agim Ademi dhe në emër të DFB-së nga presidenti i Federatës së Futbollit të Sachsenit, Hermann Winkler. "E falënderoj shumë delegacionin gjerman sepse është një marrëveshje dhe një përkrahje e pazërvë e Federatës së Futbollit të Gjermanisë që po na e jep tash e sa vjet. E falënderoj edhe

ambasadorin e nderit të Kosovës, njëherësh nënkryetarin e nderit të DFB-së, Rainer Milkoreit, për punën që e ka bërë për ne. Kjo marrëveshje është përgatitur tash e 6 muaj dhe nga e cila futbollit ynë do të përfitojë shumë", ka deklaruar Ademi.

Ndërsa presidenti i Federatës së Futbollit të Sachsenit, federatë në kuadër të Federatës Gjermane, Herman Winkler, u shpreh se kjo marrëveshje do t'i ndihmojë shumë Kosovës dhe ata do të vazhdojnë ta përkrahin FFK-në. "Unë kam respekt të jashtëzakonshëm për të arriturat e juaja, në veçanti në futboll dhe në sport, kur e dimë të gjithë se nëpër çfarë periudhe të vështirë keni kaluar. Një popull i dalë nga lufta, një popull i cili i ka pasur një mijë

telashe të tjera dhe sot me futboll jeni duke e bërë të lumtur jo vetëm popullin tuaj, por jeni duke na bërë krenarë edhe neve që po bashkëpunojmë me ju", ka thënë Winkler.

Ndërkaq nënkryetari i nderit i Federatës gjermane të Futbollit, Rainer Milkoreit, theksoi se Gjermania gjithmonë do të jetë partnere e Kosovës. "Federata e Futbollit e Gjermanisë ka qenë dhe do të mbetet një ndër partneret më të sinqerta dhe me të besueshme të FFK-së. Si në kohën e të ndjerit Fadil Vokrri, po ashtu edhe tek Agim Ademi, çdo gjë është duke funksionuar në mënyrën më të mirë të mundshme dhe ne do të vazhdojmë t'ju përkrahim", ka deklaruar Milkoreit.

## Rossi: Yamaha duhet ta marrë Quartararon

ROMË, 14 TETOR - Valentino Rossi ka edhe një vit kontratë me motorin Yamaha, çka do të thotë se ai do të zbrisë në pistë në MotoGP edhe vitin 2020. Por ende nuk dihet çfarë do të ndodhë në vitin 2021 me pilotin italian, i cili është legjendë e garave të motoçiklizmit. Rossi e ka të qartë të ardhmen dhe i jep një këshillë Yamahas: "Do të ishte një çmenduri nëse te Yamaha nuk afrojnë talentin francez Fabio Quartararo. Për mua ai është e ardhmja e Moto GP. Shpresoj që gjatë vitit tjetër ta bindin për të firmosur për Yamaha".

Fabio Quartararo debutoi këtë sezon në Moto GP dhe piloton motorin Yamaha Petronas, çka mund ta lehtësojë këtë lëvizje në merkaton e pilotëve. "Është i shpe-



jtë, konstant dhe nuk bën gabime. E njëj motorin Yamaha dhe arrin ta frenojë këtë motor më mirë se kushdo tjetër", ka shtuar Rossi.

### SHKURT

#### Bashkimi përforcohet me Stevie Clark

Basketbollisti amerikan Stevie Clark është përforcimi më i ri i skuadrës së Bashkimit. Clark luan në pozitën e organizatorit dhe është i gjatë 180 centimetra. Ai së fundi ka qenë pjesë e skuadrës nga kampionati kroat KK Hermes Analitica Zagreb, ndërsa më parë ka luajtur për kolegjet amerikane nga NCAA si Oklahoma State University, Oakland University dhe LSU Shreveport. 25-vjeçari është basketbollisti i tretë i huaj në skuadrën tonë pas dyshes Corey Raley-Ross dhe Terik Bridgeman. Clark në ndeshjen e ardhshme do ta luajë kundër Ponte Prizrenit.

#### Probleme për Lakersat, lëndohet Anthony Davis

Ende pa nisur sezoni 2019-2020 vjen dëmtimi i parë për skuadrën e Lakersit, një nga favoritët për titullin kampion në NBA. Basketbollisti Anthony Davis, i ardhur këtë verë, është dëmtuar në kyçin e dorës së djathtë. Dëmtimi erdhi në miqësoren që Lakersi luajti ndaj Brooklynit (skuadra e Nets fitoi 91-77). Davis e la në mes ndeshjen, ende pa u mbyllur pjesa e parë. Nuk dihet se sa kohë Anthony Davis do të qëndrojë jashtë fushave edhe pse rezonanca tregoi se dëmtimi nuk është i rëndë. Bëhet fjalë për një ndrydhje të shkallës së parë, duke evituar këputje të ligamenteve. Gjithsesi, ende nuk dihet nëse ylli i Lakersit dhe NBA-së do të jetë në fushë për ndeshjen e parë sezonale, derbin e Los Angelesit ndaj Clippersit.

#### Mançini rinovon kontratën me Italinë


Trajneri i Italisë, Roberto Mançini, e ka rinovuar kontratën me Federatën e Futbollit të Italisë. Ai me rinovimin e kontratës që i skadonte pas "Euro 2020", do të jetë në krye të Italisë deri në verën e vitit 2022. Rinovimi i kontratës së Mançinit ka ardhur pas kualifikimit të Italisë në "Euro 2020". Në këto eliminatorë Italia ka regjistruar shtatë fitore në po aq ndeshje.

#### Sanchezi mungon rreth tre muaj

Trajneri i Kilit, Reinaldo Rueda, ka pranuar se pret që sulmuesi i Interit, Alexis Sanchez, të jetë jashtë fushave për dy ose tre muaj. Sanchezi pësoi dëmtim të ligamentit në kyçin e këmbës gjatë barazimit 0-0 të Kilit me Kolumbinë në fundjavë dhe Rueda pranoi se ylli i tij mund të ketë nevojë për operacion për ta përmirësuar problemin. "Ai mund të përfundojë keq. Interi, klubi i tij, do të vendosë. Mund ta humbim për dy ose tre muaj. Është turp sepse ai kishte filluar të luante përsëri me Interin dhe të shënonte gola, ndërsa gjithashtu të luante në Ligën e Kampionëve. Ai ishte i lumtur dhe super i motivuar. Tani duhet të presim për këto orë vendimtare", ka thënë Rueda.

#### Van Dijk: Nuk luajtem mirë ndaj Bjellorusisë

Virgil van Dijk i gëzohet fitores, por jo paraqitjes ndaj Bjellorusisë, sfidë e cila përfundoi me rezultatin 1-2 në favor të Holandës. "E gjithë Holanda dëshiron praninë në Kampionatin Evropian e natyrisht edhe ne si grup lojtarësh. Jemi afër synimit, por duhet ta analizojmë mirë paraqitjen tonë në tërësinë e saj", ka thënë mbrojtësi që aktivizohet te Liverpooli. "Kishim mundësi të mjaftueshme për ta vendosur ndeshjen në një rezultat më komod. Pjesa e dytë ishte, ta themi butë, jo fort e mirë, pasi kemi humbur shumë topa në mesfushë, gjë që i lejoi të na kundërsulmojnë", ka shtuar Van Dijk.



	<b>Autor: GAZMEND MORINA</b>	BIMË BARISHTORE NJËVJEÇARE, ME KËRCELL TË GJATË (sh.shq.)	SHUMË I LODHUR, I KËPUTUR	EMËRORE, RASA E PARË E LAKIMIT (gram.)	LLOJ PAPAGALLI	FUTBOLLISTI ALTIN ....	SHTET I LASHTË NË EVROPË	NJË NGJYRË	I ÇMPREHE	ME VËSHTRËSI, ME SHUMË MUNDIM	<b>EPOKA E RE</b>	PJESË E MEKANIKËS QË STUDIOJ LIGJET E LËVIZJES SË TRUPAVE	
	MBARIM, PËRFUNDIM										BASHKËTING. TEFIK OSMANI		
	PAMORAL-SHMËRIA												
	SHTET NË AFRIKË (pashq.)								GAZ QË PËRDORËT PËR TË PASTRUAR PLAGËT ANA MERO				
	REGJISORI GJERMAN ... EDEL QYTET I YNI					ZEZAKU; I ZIU ISH BENDI MUZIKOR ANGLEZ "..... KITTEN"						ZANORE RRJET I QARKULLIMIT TË AUTOMJ-ETEVE	
	→							PËREMËR PRONOR				DY BASHKË-TINGËLLORE RRYMË AJRI QË LËVIZ NË DREJTIME TË NDRYSHME	
	PIKTORI YNË ... VALLA							ZANORE BËRJE MË I RI			AKTORJA AMERIKANE ... GARR ALTINI (perkdh.)		
KUJDESTAR (lat.)									KA A DEM I PATREDHUR MARKË E TELEFONAVE CELULAR				
<b>EPOKA E RE</b>	KËNGËTARJA KANADEZE NË FOTO LAVIGNE	KRYEQYTETI I NJË SHTETI EVROPIAN	ZBAVITËS, TËRHEQËS	NIKEL	KUFI	ZANORE	QYTET NË ITALI MALESOR				"F" në mes të dy "A" PRARJ		
GRADIM, PËRPARIM	○											ZANORE MARRJE E TIPAREVE TË PARAARDHËSVE TANË	PËRGËZIM
QYTET NË KOSOVË	○					ALYSA MILANO MOR, HEJ (pashq.)		BIMË QË BËN KOKRRA TË THARA (shq.) ENDACAKE					
RENIUM, REOMIR	○			SKLLAV I LIRUAR (hist.) FUTBOLLISTI BRAZILIAN ... SILVA (MILAN)				NOTË MUZIKORE KALORËS MESJETAR		OHAJO, LUIZIANA AKTORI YNË ... HAZIRI		BASHKËTING. KËNGËTARJA SHQIPTARE ANILA .....	
ZEMËRIM, EGËRSIM	○				PJESË RROTULLUESE E NJË APARATI MITRUSH KUTELI				SHKOLLIMI, ARSIMIMI (bised.) ARKIVI I FILMAVE				
LAKESË	○					AKTOR KOMEDISH MODELJA SHQIPTARO-AMERIKANE ÇUNMULAJ			ZANORE BASHKËTING.		SHTEG SECILA NGA PJESËT E NJË NDËRTESE (pashq.)		
<b>EPOKA E RE</b>	QESËNDISJE	KËNGËTARJA ANITA ... TMERR				ZYRTARIZIM I NJË MARR-ËVESHJE NDËRKOMBËTARE BURIMI						SMIRË	
I DOBËT, TINËZAR					BENDI MUZIKOR "IRON ....." PËRMBLEDHJE E SISTEMUAR UDHËZIMESH (shq.)				SHPEND I EGËR ME BISHT TË GJATË DETERGJENT PËR DUAR				
SHFUQIZIM I NJË AKTI JURIDIK							KËNGËTARI ITALIAN RAMAZZOTTI DREJTOJ NJË AUTOMJET				KËNGËTARJA JONË ... SHKODRA BASHKËTING.		
OMANI, BENINI			FUTBOLLISTI BEHRAMI	BASKETBOLLISTI TURK OMER ... AKTORI FRANCEZ DELON (shq.)				MODELJA SHQIPTARE FEJZULLAHU	GOTË PREJ METALI BASHKËTING.		SHOK, JARAN GJELLË E PËRGATITUR VETËM ME ORIZ		
SHTET FEDERAL NË SHBA					MYNXYRË: HALL I MADH AI QË E KISHTE DOBËSI THEMBREN					PESCARA, IVREA AKTORJA ME FAMË BOTËRORE ... REID		ZANORE SHTRESË E SIPËRME E AJRIT	
SHTET NË EVROPË (pashq.)					"R" pas dy "A" AKTORJA ME FAMË BOTËRORE ... FARIS			ARKË SHUMË E VOGËL PREJ KARTONI			ERBIUM EUROPEAN TRAIN ENTHUSIAST		
KAMBANË FARE E VOGËL					BOSHTI ARIAN MALIQI				JETËSHKRIM (sh.shq.) DY BASHKË-TINGËLLORE				TONY ANDERSON
ZANORE		MËNYRË ARTIFICIALE E EPSHIT ISLANDA					SHKRONJA XXVIII & XXVI		PASURITË E PATUNDSHME QË SILLNIN TË ARDHURA URUGUAI				
I ULËT E I TILLË SA MË S'BËHET							FILLIMI I AGIMIT			SKANDALI			

ZGJIDHJA E FJALËKRËJT: FINLIZIMI, AMORALITETI, SOMALI, REVOKIM, EROS, TINA, OB, ONAN, TAS, MIK, NEVADA, GAZEP, PI, A, ITALI, AAR, KUTI, ER, ZILE, AKSI, AVANCI, VINOVA, I, VITIA, AM, KIKIRIKU, RER, KOLON, MI, OL, R, INAT, ROTOR, ARSIMI, LAKIM, KOMIK, A, RIM, TAKE, RATIFIKIM, I LIG, MAIDEN, FAZAN, REVOKIM, EROS, TINA, OB, ONAN, TAS, MIK, NEVADA, GAZEP, PI, A, ITALI, AAR, KUTI, ER, ZILE, AKSI, AVANCI, VINOVA, I, VITIA, AM, KIKIRIKU, RER, KOLON, MI, OL, R, INAT, ROTOR, ARSIMI, LAKIM.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

**RC COLA**  
Columbus, Georgia, USA  
Since 1909